


AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

PLATFORMË PËR RIMËKËMBJEN E ARSIMIT NË KOSOVË



PRISHTINË
2021

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

PLATFORMË PËR RIMËKËMBJEN E ARSIMIT NË KOSOVË



“Nuk e di a do të bëhet më mirë kur të jetë ndryshe. Por, patjetër duhet të jetë ndryshe për t’u bërë më mirë.”¹

Georg Christoph Lichtenberg (1742-1799)

FALËNDERIME

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës falënderon grupin bërthamë të punës: Justina Shiroka-Pula, Lindita Aliu-Tahiri, Dukagjin Pupovci dhe Blerim Rexha.

Akademia, më tutje falënderon edhe anëtarët e grupit të gjerë të punës: Fetah Podvorica, Arsim Bajrami, Anton Berishaj, Hysen Bytyqi, Avdullah Alija, Jusuf Thaçi, Xhavit Rexhaj, Bardh Rugova, Luan Mulliqi, Blerim Saqipi, Linda Grapci-Kotori, Furtuna Mehmeti, Shemsi Krasniqi, Bekim Baliqi, Jehona Lushaku-Sadriu, Kreshnik Hoti, Bujar Krasniqi, Edmond Hajrizi, Drita Kadriu, Anton Gojani, Bardha Qirezi, Berat Rukiqi dhe Fikrije Zymberi për kontributin e tyre në diskutime dhe në sugjerime gojore dhe me shkrim.

¹ „Ich weiss nicht, ob es besser wird, wenn es anders wird. Aber es muss anders werden, wenn es besser werden soll.“

PARATHËNIE

Kriza e arsimit në Kosovë është gjithëpërfshirëse, nuk është ndalur te një dimension i saj, te një segment ose te një faktor, por është kthyer në krizë vlerash të një shoqërie të tërë. Duke qenë gjithëpërfshirëse, duke mos u ndalur te asnjë institucion i veçantë në mënyrë eksplicite, as vetëm te një marrëdhënie, as te një kategori profesionale, te një segment institucional, as vetëm te qeverisja ose te disa përbërës shoqërorë; duke qenë krizë e stërzgatur, që i ka përshkuar të gjitha fazat e shtetndërtimit të Kosovës; duke i përfshirë të gjithë faktorët politikë, të gjitha segmentet e shoqërisë dhe të gjitha institucionet; pra, në një rrethanë të këtillë, askush nuk dëshiron ta marrë përgjegjësinë për një gjendje të këtillë, gjithnjë duke u mbajtur pas idesë se kriza në arsim është aq e thellë dhe aq gjithëpërfshirëse sa të mos jetë në gjendje ta zgjidhë askush dhe marrja e çfarëdo përgjegjësie në këtë rrethanë nuk nxjerr askënd faqebardhë.

Kjo mund të ketë qenë arsyeja pse edhe te disa pjesëmarrës potencialë është vërejtur njëfarë ngurrimi për t'u përfshirë në hartimin e kësaj Platforme, duke konsideruar se Akademia nuk ka qenë në asnjë rrethanë, dhe as tani nuk është, përgjegjëse për situatën e krijuar dhe se përfshirja e saj në një diskutim të këtillë vetme sa mund t'i bëjë dëm këtij institucioni.

Duke konsideruar se asnjë nivel institucional në Kosovë dhe asnjë segment i shoqërisë nuk mund të amnistohet nga përgjegjësia për situatën e krijuar, Akademia ka hartuar këtë platformë për zgjidhjen e krizës së arsimit në Kosovë, duke synuar të sublimojë pikëpamje divergjente dhe interesa të dispersuara të përfaqësuesve të ndryshëm të institucioneve dhe të segmenteve të caktuara të shoqërisë, kryesisht të përfshirë drejtpërdrejt në sistemin e arsimit, njohës të mirë të problematikes, gjithnjë duke i krijuar hapësirë mendimit të lirë dhe pikëpamjeve të ndryshme për shkaqet e krizës dhe mundësitë e daljes prej saj.

Marrë në përgjithësi, dokumenti ka arritur të identifikojë qartë pikat themelore të krizës, duke bërë të ditura edhe fazat e saj si dhe faktorët që e kanë nxitur ose e kanë shkaktuar atë, siç janë:

1. Shpërbërja e sistemit të arsimit gjatë viteve '90 dhe pamundësia e ndërtimit të një sistemi arsimor të konsoliduar pas vitit 1999;
2. Ndërhyrja e UNMIK-ut në sistemin e arsimit, me përvoja konfuze dhe direktiva të paharmonizuara midis bartësve të ndryshëm të administrimit ndërkombëtar, duke mos u kufizuar vetëm te ngritja e infrastrukturës;
3. Përfshirja e arsimit të lartë në Procesin e Bolonjës, duke synuar transicion të përshpejtuar dhe duke kaluar nga sistemi tradicional në një sistem të avancuar pa fazë përgatitore dhe pa njohjet përkatëse;

4. Mosngritja e institucionit të përgjegjësisë dhe të llogaridhënies në asnjë nivel institucional të arsimit;
5. Futja në sistem e arsimit privat të pakontrolluar, në një fazë kaotike të “tregut të lirë” të nxënies spekulative, si mundësi për përfitim të papërgjegjshëm;
6. Legjislacioni i paharmonizuar me kushtet dhe rrethanat e arsimit në Kosovë, veçmas decentralizimi i arsimit parauniversitar dhe bartja e kompetencave në nivel të pushtetit lokal, me ndërhyrjet sistemore që burojnë nga “Pakoja e Ahtisaarit”;
7. Ndërhyrjet politike në sistemin e arsimit (emërimet politike, akreditimet dhe licencimet, hapja e universiteteve lokale, bordet, kuotat e regjistrimit të studentëve etj.);
8. Ndërhyrjet e sindikatave dhe të shoqërisë civile në sistemin arsimor, të nxitur nga përfitimet dhe të motivuar nga interesat tërësisht joparimore etj.

Për ta tejkaluar këtë gjendje të arsimit në Kosovë nuk do të mjaftojë asnjë platformë, pavarësisht se nga kush hartohet dhe kush mbështet, sepse kriza është aq komplekse sa që është vështirë të tejkalohet pa një vetëdije të përgjithshme dhe pa ngritur institucionin e përgjegjësisë. Që kjo të ndodhë, përveç se duhet të krijohet një vetëdije shoqërore, është i domosdoshëm një aksion politik gjithëpërfshirës, i cili do të niste nga institucionet e larta të pushtetit dhe të vendimmarrjes, duke përfshirë të gjitha nivelet e shoqërisë.

Akademia do t’ua vërë në dispozicion këtë platformë të gjitha palëve të interesuara dhe opinionit, duke mbështetur fuqishëm hapjen e një diskutimi të gjerë shoqëror dhe duke përmbushur kështu një obligim të vetëkonsideruar të tillë për institucionin më të lartë të shkencës dhe të artit në Kosovë.

Përfitoj nga rasti të falënderoj grupin për hartimin e kësaj platforme, në mënyrë të veçantë sekretaren e Seksionit të Shkencave Shoqërore të ASHAK-ut, anëtarin korrespondente Justina Shiroka-Pula për angazhim këmbëngulës dhe të pakursyer në punët e koordinimit rreth diskutimit të çështjeve dhe për hartimin e tekstit të Platformës.

Akademik Mehmet Kraja,

Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

SHKURTESAT

AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
ASHAK	Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës
ASK	Agjencia e Statistikave e Kosovës
BE	Bashkimi European
BPV	Bruto Produkti Vendor
DKA	Drejtoria Komunale e Arsimit
ENQA	Rrjeti European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
EQAR	Regjistri Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë
IAL	Institucione të Arsimit të Lartë
MASHT	Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	1
SHKURTESAT	3
LISTA E FIGURAVE	6
LISTA E TABELAVE	6
1. HYRJE	7
2. KONTEKSTI SHOQËROR DHE EKONOMIK	9
2.1. KONTEKSTI POLITIK	9
2.2. PARAMETRAT KRYESORË MAKROEKONOMIKË	10
2.3. TABLOJA DEMOGRAFIKE – PERSPEKTIVAT E ZVOGËLIMIT SË POPULLSISË	12
3. SFIDAT E ARSIMIT DHE MASAT PËR RIMËKËMBJE	15
3.1. ARSIMI NË KOSOVË 1999 - 2020	15
3.2. SFIDAT E PËRGJITHSHME	19
3.2.1. Qeverisja dhe llogaridhënia	19
3.2.2. Financimi i arsimit	22
3.2.3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit	24
3.2.4. Arsimi në funksion të punësimit dhe zhvillimit	26
3.3. ARSIMI PARAUNIVERSITAR	30
3.3.1. Pjesëmarrja në arsim	30
3.3.2. Cilësia e arsimit	32
3.3.3. Mbikëqyrja, inspektimi dhe vlerësimi i jashtëm	37
3.3.4. Infrastruktura dhe rrjeti i shkollave	39
3.4. ARSIMI I LARTË	40
3.4.1. Institucionet dhe programet e arsimit të lartë	41
3.4.2. Sa janë cilësore diplomat tona	43
3.4.3. Integriteti dhe transparencë	46
3.4.4. Organizimi studentor në funksion të klaneve	47
3.4.5. Kërkimi shkencor	49
4. PËRFUNDIM	52

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: BPV për kokë banori në vendet e Ballkanit	11
Figura 2: Shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor	12
Figura 3: Projeksioni i grup-moshave të popullsisë së Kosovës sipas viteve në përqindje (varianti i mesëm)	13
Figura 4: Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV-në.....	22
Figura 5: Rezultatet e testit PISA 2018.....	34
Figura 6: Raporti bruto i regjistrimit në arsimin e lartë	41
Figura 7: Krahasimi i institucioneve të arsimit të lartë në rajon.....	44
Figura 8: Renditja e universiteteve të rajonit sipas indeksimit në SCIMAGO	51

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Numri i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në institucionet edukative- arsimore të Kosovës.....	18
Tabela 2: Ndërlidhja e stafit të Agjencisë me cilësinë në IAL	45

1. HYRJE

Më shumë se dy dekada pas përfundimit të Luftës, arsimi në Kosovë është larg përmbushjes së misionit të vet – përgatitjes së gjeneratave të reja për jetë. Rezultatet e testit PISA tregojnë se 15-vjeçarët kosovarë ngecin në fushën e leximit për më shumë se 3 vjet shkollimi në raport me moshatarët e tyre në vendet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe për 1-2 vite shkollimi në raport me fëmijët nga vendet fqinje. Përveç kësaj, rreth 79 për qind e fëmijëve 15 vjeç nuk posedojnë shkathtësi minimale në fushën e leximit, që ka efekt zinxhiror në të gjitha disiplinat e tjera dhe në të gjitha fushat e jetës. Gjendja nuk është më e mirë as në dy fushat e tjera që i vlerëson testi PISA, atë të matematikës dhe të shkencave të natyrës, që e konfirmon kompleksitetin e gjendjes.

Kosova vazhdon të jetë vendi më i varfër në Europë dhe, pa dyshim, një pjesë e përgjegjësisë për këtë gjendje duhet t'i atribuohet edhe cilësisë së arsimit. Studimet tregojnë se mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar paraqet pengesë serioze për rritjen ekonomike. Kompani të shumta raportojnë për problemet në identifikimin e punonjësve të kualifikuar, në masë të madhe për shkak të mungesës së shkathtësive të kërkuara. Ndërkaq, kompanitë serioze dhe të orientuara kah eksporti duhet të investojnë shuma të mëdha për të kompensuar përgatitjen joadequate gjatë shkollimit të rregullt. Papunësia vazhdon të jetë më e larta në Europë, por me trend të qartë zvogëlimi jo për shkak të zhvillimit ekonomik, por si pasojë e rënies së vazhdueshme të natalitetit dhe migrimit. Mendohet se trendi i migrimit do të vazhdojë për shkak të nevojës së shtuar të vendeve të zhvilluara për punonjës të kualifikuar, me perspektivë reale që ata të cilët nuk posedojnë shkathtësi të kërkuara të mbeten në Kosovë.

Në dy dekadat e fundit është shënuar sukses i madh në rritjen e pjesëmarrjes në arsim në të gjitha nivelet, sidomos te grupet shoqërore të marginalizuara: vajzat-gratë, të varfrit, personat me aftësi të kufizuara, romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët. Pjesëmarrja në arsimin fillor dhe të mesëm në Kosovë është e krahasueshme me çdo vend evropian, por pjesëmarrja në edukimin parashkollor prej 4-5 për qind mbetet më e ulët në Rajon dhe në Europë. Ndërkaq në arsimin e lartë Kosova i tejkalon shumë vende evropiane, mirëpo pjesëmarrja e shtuar në arsim nuk është shoqëruar edhe me ofrim të arsimit cilësor.

Përveç që kanë lejuar degradimin e cilësisë së arsimit, institucionet e Kosovës nuk ia kanë dalë ta ndërtojnë një sistem të bazuar në përgjegjësi dhe llogaridhënie. Problemi kryesor qëndron te moszbatimi i legjislacionit, strategjive, politikave dhe standardeve të proklamuar, si dhe te politizimi i skajshëm i sistemit të arsimit, i cili shpërfaqet në forma të ndryshme, duke filluar nga punësimet partiake në institucione arsimore e deri te marrja e vendimeve për arsimin në nivelet komunale dhe qendrore që janë të motivuara nga interesat e ngushta partiake, e jo nga

interesi publik. Janë bërë shumë hapa të gabuar edhe atëherë kur ka qenë e qartë se nuk do të sjellin asnjë të mirë. Për fat të keq ka munguar një reagim më i zëshëm ndaj këtyre trendëve si nga ana e politikëbërësve, ashtu edhe nga ana e komunitetit akademik, komunitetit të biznesit, shoqërisë civile, medias dhe, në përgjithësi, nga ana e qytetarëve.

Një gjendje e tillë e nxiti Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (ASHAK), si promotore kryesore e zhvillimit të mendimit shkencor dhe të krijimtarisë artistike që të shprehë qëndrimin e vet rreth problemeve kyçe të arsimit në Kosovë, duke identifikuar faktorët që ndikojnë në shfaqjen e këtyre problemeve dhe duke propozuar masa për rimëkëmbjen e arsimit në vend. Ky është edhe qëllimi i kësaj Platforme e cila u adresohet institucioneve shtetërore dhe opinionit të gjerë publik.

“Platforma për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë” është produkt i punës ekipore dhe konsultimeve të gjera, ku kanë marrë pjesë anëtarë të ASHAK-ut dhe ekspertë që merren me problematika të arsimit nga komuniteti akademik, institucionet shtetërore, komuniteti i biznesit dhe shoqëria civile. Procesi është drejtuar nga grupi i punës i përbërë nga anëtarë të ASHAK-ut dhe profesionistë e hulumtues jashtë ASHAK-ut. Pas konsultimeve fillestare janë organizuar dy tryeza pune për analizën e gjendjes në arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë, ku janë diskutuar problemet kyçe të arsimit dhe janë shpalosur ide për adresimin e tyre. Pastaj nëngrupet për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë kanë hartuar raporte të zgjeruara të analizës së gjendjes dhe kanë propozuar ide për adresimin e problemeve kyçe brenda sektorit përkatës.

Mbi bazën e këtyre materialeve Grupi i Punës ka hartuar draftin e dokumentit, i cili është përpunuar pas komenteve nga Kryesia e Akademisë dhe është miratuar në versionin përfundimtar në mbledhjen e Kryesisë të mbajtur më 27 nëntor 2020.

2. KONTEKSTI SHOQËROR DHE EKONOMIK

2.1. Konteksti politik

Pas përmbylljes me sukses më 17 shkurt 2008 të procesit të gjatë të krijimit të shtetit të Kosovës, filloi faza tjetër e konsolidimit të shtetësisë, e shtetndërtimit të brendshëm dhe e forcimit të pozitës juridike dhe politike në nivel ndërkombëtar. Në aspektin e shtetndërtimit të brendshëm fillimisht është miratuar Kushtetuta, pastaj edhe ligjet bazike, të cilat kanë vendosur strukturën themelore institucionale, për të vazhduar me procesin e përmbylljes së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë dhe konsolidimit të përgjithshëm institucional shtetëror. Edhe në aspektin e jashtëm Republika e Kosovës në vitet e para pas pavarësisë fitoi një pozicion të favorshëm ndërkombëtar, duke u njohur nga më shumë se 100 shtete anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, prej tyre pjesa më e madhe shtete anëtare të BE-së dhe NATO-s dhe duke vazhduar me anëtarësimin në organizata të rëndësishme ndërkombëtare. E gjithë kjo përfundimisht çoi drejt procesit të bërjes së shtetit të Kosovës si një realitet tashmë i pakthyeshëm juridik e gjeopolitik në rrafshin ndërkombëtar.

Situatën në vend dhe në rrafshin ndërkombëtar vazhdojnë ta rëndojnë raportet aktuale të parregulluara ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Tashmë disa vite Serbia e ka vendosur në agjendën zyrtare shtetërore fushatën kundër njohjes së shtetit të Kosovës nga shtetet e tjera, por edhe kundër anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare. Po ashtu, komuniteti serb që jeton në Kosovë nxitet në vazhdimësi nga Serbia që të sfidojë autoritetin e institucioneve të Kosovës, duke krijuar një gjendje pasigurie dhe jostabiliteti politik.

Procesi i transicionit politik në Republikën e Kosovës dhe aq më tepër ballafaqimi me sfidat e ndërtimit të shtetit ligjor si mungesa e sundimit të ligjit, respektimi i duhur i rendit juridik-kushtetues, korrupsioni, krimi i organizuar, rreziku nga terrorizmi, mungesa e stabilitetit politik, ndrydhja e demokracisë qytetare, moszhvillimi ekonomik etj. lidhet kryekëput me ndërtimin e shtetit ligjor si një proces i domosdoshëm në ato vende që kanë kaluar në rrugën e ndryshimit të sistemeve politike, siç është rasti me Kosovën. Njëra ndër sfidat kryesore të ndërtimit të shtetit ligjor mbetet mungesa e sundimit të ligjit, në shumë raste si rezultat i cenimit të pavarësisë së pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të drejtësisë, por edhe institucioneve të tjera kushtetuese të pavarura dhe si rezultat i saj mungon zbatimi i ligjit dhe kushtet për punë efikase dhe efektive, të drejtë dhe të pavarur.

Pas një procesi të gjatë të negociatave dhe përmbushjes së shumë kriterëve, në vitin 2015 është nënshkruar Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit midis Kosovës dhe BE-së, për të hyrë në fuqi një vit më vonë. Duke qenë akti më i lartë juridik i

vendosjes së marrëdhënieve kontraktuale, në të, përpos shumë fushave, përcaktohet edhe detyrimi që të zhvillohet procesi i dialogut me Serbinë, si kusht i domosdoshëm për progres drejt integritimit.

2.2. Parametrat kryesorë makroekonomikë

Gjatë periudhës 2008-2019 Kosova kishte një rritje të vazhdueshme të aktiviteteve ekonomike, me vlerë nominale të brutoproduktit vendor (BPV) me rreth 5.501 milion euro dhe me një normë reale të rritjes prej 6.0 për qind (2014), ndërsa në vitin 2019 vlera nominale e BPV-së ishte rreth 7.066 milion euro, me një normë reale të rritjes prej 4.9 për qind.²

Gjatë këtyre viteve rritja ekonomike ishte brenda parametrave që pasqyrojnë një situatë stabile makroekonomike si në sektorin fiskal ashtu edhe në atë financiar. Pavarësisht që Kosova në vazhdimësi kishte rritje të ekonomisë dhe rritje të të ardhurave për kokë banori, megjithatë, ajo mbetet larg BPV-së për kokë banori me vendet e Ballkanit,³ si tregon Figura 1.

Nga viti 2008 të hyrat buxhetore në Kosovë u rritën me normën vjetore prej 2-4 për qind, duke e ruajtur disiplinën fiskale dhe stabilitetin makroekonomik. Kështu, të hyrat e përgjithshme të Qeverisë së Kosovës në vitin 2017 ishin rreth 1.8 miliard euro, për vitin 2019 arritën vlerën 2.3 miliard euro, ndërsa për vitin 2020 janë 2.6 miliard euro.⁴

Në përgjithësi remitancat kanë ndikim të shumëfishtë në aspektet kryesore të zhvillimit në Kosovë. Të hyrat nga remitancat janë në rritje si rezultat i trendit të rritjes së emigrimit të rregullt për qëllime të punësimit. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Kosovës⁵ vetëm gjatë vitit 2018 në Kosovë janë dërguar mbi 800 milion euro nga diaspora, që paraqet rritje prej 5.3 për qind në raport me vitin paraprak.⁶

Pavarësisht treguesve të tjerë ekonomikë, krijimi i bizneseve të vogla dhe të mesme konsiderohet faktor shtytës i dinamikës zhvillimore dhe ato vazhdojnë të jenë bartëse kryesore të krijimit të vendeve të reja të punës, megjithëse larg dinamikës së dëshiruar. Arsyeja kryesore për këtë qëndron në faktin se mbi 90 për qind të bizneseve të

² Agjencia e Statistikave e Kosovës: Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2020. <https://ask.rks-gov.net/media/5492/vjetari-final-2020-per-web.pdf>

³ CIA: *The World Fact book 2016* — Central Intelligence Agency. <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/kv.html>


⁴ Ministria Financave: Buxheti i Republikës së Kosovës 2020. <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/9D16BECD-DDF8-4144-BCBB-4CE9945F5CDD.pdf>

⁵ Banka Qendrore e Kosovës: Buletini mujor statistikor nr. 225, 2020. https://bqk-kos.org/repository/docs/2018/BQK_BMS_225_al.pdf

⁶ Autoriteti Qeveritar për Migrim: Profili i lehtë i migrimit 2017.

regjistruara janë mikrobiznese, me më pak se 10 të punësuar,⁷ e që nuk pritet të jenë bartës të zhvillimit të një ekonomie moderne. Me gjithë përmirësimin e kushteve të të bërit biznes në Kosovë,⁸ mungesa e shkathtësive të kërkuara nga tregu i punës është identifikuar si pengesë e vazhdueshme për rritjen e sektorit privat.⁹

Figura 1. BPV për kokë banori në vendet e Ballkanit



Sipas Anketës së fuqisë punëtore,¹⁰ në vitin 2019 mbi dy të tretat e popullsisë në Kosovë ishin në moshë pune (15 - 64 vjeç), ndërsa shkalla e punësimit ishte vetëm 30.1 për qind (meshkujt - 46.2 për qind, femrat - 13.9 për qind). Po ashtu shkalla e joaktivitetit është jashtëzakonisht e lartë krahasuar me vendet e tjera evropiane: 59.5 për qind e popullsisë në moshën e punës nuk janë të punësuar dhe nuk kërkojnë punë – prej tyre 40.3 për qind e meshkujve dhe 78.9 për qind e femrave. Pavarësisht rritjes së numrit të bizneseve dhe kërkesës së kompanive private për punë të kualifikuar, profesionale dhe inovative, Kosova ende përballet me nivele të larta të papunësisë. Të dhënat e Anketës tregojnë papunësi prej 25.7 për qind (te meshkujt 22.6 për qind, te femrat 34.4 për qind). Ndërkaq, numri i të rinjve të moshës 15 - 24

⁷ Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), MTI.

⁸ World Bank Group: *Doing Business 2019 – Training for reform*.
https://www.doingbusiness.org/content/dam/doingBusiness/media/Annual-Reports/English-DB2019-report_web-version.pdf


⁹ B. Krasniqi, IESB Institute: Labour Market and Skills Needs Analysis; Perspective for the future. Kosovo: Publication of "Aligning Education and Training with Labour Market Needs 2" project. ISBN: 978-9951-8990-0-0.
http://alled.eu/wp-content/uploads/2019/10/Report-Draft-215x215mm_print30092019.pdf

¹⁰ Agjencia e Statistikave e Kosovës: Anketa e fuqisë punëtore 2019.
<https://ask.rks-gov.net/media/5369/anketa-e-fuqispërqindC3përqindAB-punpërqindC3për-qindABtore-afp-2019.pdf>

vjet që nuk ndjekin shkollën, nuk janë të punësuar dhe nuk ndjekin kurse, aftësime e trajnime është 32.7 për qind (Meshkujt 31.4 për qind, femrat¹¹ 34.2 për qind).

Sipas një raporti të sponsorizuar nga Banka Botërore¹² shkalla e papunësisë e popullatës në moshë pune për vitin 2019 (T2),¹³ për personat me arsim të lartë është 22.4 për qind, me arsim të mesëm 23.9 për qind dhe me arsim të ulët 34.2 për qind, ndërsa nga Figura 2 shihet si ka ndryshuar kjo gjendje në vitet e fundit.

Figura 2. Shkalla e papunësisë sipas nivelit arsimor



Duke u bazuar në këtë trend të rritjes ekonomike dhe në nivelin e tanishëm të papunësisë, përqendrimi duhet të jetë në cilësinë e edukimit dhe të arsimit në mënyrë që rinia të pajiset me dije, me aftësi dhe me shkathtësi që kërkohen nga kompanitë, përkatësisht me ato profile që janë të nevojshme për tregun e punës.

2.3. Tabloja demografike – perspektivat e zvogëlimit së popullsisë

Regjistrimi i fundit i plotë i popullsisë në ish-Jugosllavi është bërë më 1981 dhe, sipas tij, Kosova në atë kohë kishte 1.584.440 banorë.¹⁴ Ndërkaq, sipas rezultateve

¹¹ Termi “femra” këtu përdoret në përputhje me terminologjinë e burimit, dhe pa asnjë nënkuptim nënçmues nga aspekti gjinor.


¹² Vienna institute for International Economic Studies: Western Balkans Labor Market Trends 2019. World Bank Group.
<http://documents1.worldbank.org/curated/en/351461552915471917/pdf/135370-Western-Balkans-Labor-Market-Trends-2019.pdf>

¹³ T2 të dhënat e tremujorit të dytë të vitit 2019.

¹⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës: Ndryshimet demografike të popullsisë së Kosovës në periudhën 1948-2006, shkurt 2008.

të regjistrimit të vitit 2011, numri i popullsisë rezidente në Kosovë ishte 1.739.825 banorë,¹⁵ mirëpo në këtë regjistrim nuk janë përfshirë banorët e komunave Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan dhe Mitrovicë e Veriut. Popullsia në Kosovë për vitin 2019 vlerësohet që ishte 1.782.115 banorë, sipas këtij vlerësimi prej 0 – 14-vjeçar janë 28 për qind, 15 - 64 vjet janë 65 për qind dhe 65+ vjet janë 7 për qind.¹⁶

Figura 3. Projektioni i grup-moshave të popullsisë së Kosovës sipas viteve në përqindje (varianti i mesëm¹⁷)



Parashikimi i Popullsisë së Kosovës për periudhën 2017 – 2061,¹⁸ varianti i mesëm, flet për një rritje të lehtë të popullsisë deri në vitin 2031, për të vazhduar me trendin

<https://ask.rks-gov.net/media/1834/ndryshimet-demografike-te-popullsisë-se-kosoves-ne-periudhen-1948-2006.pdf>

¹⁵ Agjencia e Statistikave e Kosovës: *Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2011*, Rezultatet përfundimtare.

<https://ask.rks-gov.net/media/2074/te-dhenat-kryesore.pdf>

¹⁶ Agjencia e Statistikave e Kosovës: Vlerësimi i popullsisë së Kosovës 2019, 2020.

<https://ask.rks-gov.net/media/5536/vleresimi-i-popullsisë-2019.pdf>

¹⁷ Varianti i mesëm është një nga tri opsionet (varianti i lartë, varianti i mesëm dhe varianti i ulët) e trendëve demografike për periudhën e caktuar. Për shfrytëzimin e të dhënave rekomandohet që varianti i mesëm të shfrytëzohet gjatë planifikimit dhe analizave të ndryshme dhe konsiderohet më realiste nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

¹⁸ Agjencia e Statistikave e Kosovës: *Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2017 – 2061*, dhjetor 2017. <https://ask.rks-gov.net/media/3742/parashikimi-i-popullsisë-se-kosoves-2017-2061.pdf>

e zvogëlimit së saj deri në vitin 2061. Sipas këtij parashikimi, popullsia në Kosovë do të ketë 1.809.458 banorë në vitin 2021; 1.818.674 (2031); 1.759.492 (2041); 1.652.090 (2051) dhe 1.492.192 (2061). Arsyeja e zvogëlimit qëndron te trendi i qartë i zvogëlimit të lindjeve dhe rritjes së emigrimit për shkak të kushteve ekonomike.

Popullsia e Kosovës do të pësojë një ndryshim drastik në strukturën e saj moshore që manifestohet përmes zvogëlimit të popullsisë së re (nga 0-14 vjet) nga 25 për qind (2017), në 20 për qind (2031) dhe 13 për qind (2061). Njëkohësisht do të rritet pjesëmarrja e grup-moshës 65+ vjet në strukturën e popullsisë nga 8 për qind (2017) në 13 për qind (2031) dhe 27 për qind (2061), siç është paraqitur te Figura 3.

Zvogëlimi i popullsisë së moshës shkollore tanimë vërehet edhe nga zvogëlimi i numrit të nxënësve në arsimin parauniversitar. Kështu, në vitin shkollor 2010/11 numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë ka qenë 410.756, ndërsa në vitin shkollor 2019/20 ka rënë në 312.498, që paraqet zvogëlim prej 23.9 për qind brenda më pak se një dekade.¹⁹

¹⁹ MASHT, Statistikat e arsimit për vitet shkollore përkatëse - <https://masht.rks-gov.net/statistikat>

3. SFIDAT E ARSIMIT DHE MASAT PËR RIMËKËMBJE

Për dekada me radhë problemi kryesor i arsimit në Kosovë ka qenë përfshirja e ulët, e cila ka rezultuar me nivelin jo të kënaqshëm arsimor të popullsisë. Sipas regjistrimit të vitit 2011 vetëm 10.4 për qind e qytetarëve të moshës 30 - 34 vjet²⁰ kanë pasur të përfunduar ndonjë formë të studimeve të larta, për dallim nga vendet e Bashkimit Europian ku përqindja e të tillëve ishte 34.8 për qind në vitin 2011, ndërsa në vitin 2019 arriti në 41.6 për qind.²¹ Regjistrimi i vitit 2011 nxjerr në pah edhe disparitetet gjinore në nivelin arsimor, meqë përqindja e grave të moshës 30 - 34 vjet që kanë mbaruar ndonjë formë të arsimit të lartë është 9.2 për qind, ndërsa e burrave – 11.7 për qind. Besohet se dekada e fundit ka sjellë një përmirësim të nivelit arsimor të popullsisë dhe ka ndikuar në zvogëlimin e disparitetit gjinor, por në këto aspekte Kosova akoma nuk mund të krahasohet me vendet e Bashkimit Europian dhe as me vendet e Ballkanit.

Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011²² gjithsej 55.001 qytetarë të Kosovës të moshës mbi 10 vjet nuk dinë lexim dhe shkrim, prej të cilëve 70 për qind janë të moshës mbi 55 vjet. Me shkallën e analfabetizmit prej 3.85 për qind Kosova është 1-2 për qind prapa shumicës së vendeve europiane, por qëndron më mirë se disa vende të zhvilluara evropiane, siç janë Portugalia e Turqia. Për shkak të rritjes së pjesëmarrjes në arsim pritet që dukuria e analfabetizmit klasik në Kosovë të jetë zvogëluar, gjë që do të kuptohet nga regjistrimi i popullsisë i vitit 2021. Megjithatë, në Kosovë nuk dihet asgjë për praninë e analfabetizmit funksional, që ka të bëjë me personat që nuk kanë aftësi lexim-shkrimi dhe numeracioni të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e tyre të përditshme. Në këtë fushë nuk ka pasur studime të veçanta, por nga krahasimi me disa vende europiane që kanë numër të konsiderueshëm të analfabetëve funksionalë dhe performanca e dobët e 15-vjeçarëve në testin PISA, mund të supozohet se shkalla e analfabetizmit funksional në Kosovë është brengosëse.

3.1. Arsimi në Kosovë 1999 - 2020

Përfundimi i luftës në Kosovë në qershorin e vitit 1999 e gjeti arsimin në një gjendje jashtëzakonisht të rëndë, si pasojë e represionit shtetëror serb gjatë viteve të 90-ta, që kulmoi me operacione policore-ushtarake me efekte shkatërruese në vitet 1998 dhe 1999. Një vlerësim i infrastrukturës shkollore i bërë nga UNICEF në verën e vitit 1999 tregoi se 38.9 për qind e objekteve shkollore ishin të shkatërruara ose

²⁰ Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK); (dhjetor 2013), Atlasi I Regjistrimit të Popullsisë Kosovë.

²¹ Eurostat: Population aged 30-34 with tertiary educational attainment level by sex, Updated: 06.08.2020.

https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/show.do?dataset=yth_educ_020&lang=en

²² Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK); (dhjetor 2013), Atlasi I Regjistrimit të Popullsisë Kosovë.

të riparueshme, ndërsa 24.2 për qind me dëmtime, por të riparueshme.²³ Për të krijuar kushte për rifillimin e mësimi, autoritetet ndërkombëtare dhe organizatat humanitare i dhanë përparësi rindërtimit dhe riparimit të objekteve shkollore, ndërsa viti i parë shkollor i pasluftës filloi sipas kalendarit më 1 shtator 1999 për arsimin parauniversitar, përkatësisht më 1 tetor 1999 për institucionet e arsimit të lartë. Në vitin shkollor 1999/2000 mësimin në institucionet arsimore të Kosovës e vijuan 374.764 nxënës dhe studentë (272.045 në arsimin fillor, 80.661 në arsimin e mesëm dhe 22.058 në arsimin e lartë) ose 11 për qind më shumë se në vitin shkollor 1997/98.²⁴

Segregacioni i imponuar nga pushteti serb në vitet e 90-ta ka rezultuar me pasoja serioze për cilësinë e arsimit në Kosovë. Organizimi i mësimi në objekte private dhe hapësira që nuk sigurojnë kushte minimale për punë, me orare të shkurtuara, me mundësi më se të kufizuara për përcjelljen e trendëve bashkëkohore dhe për ndryshime pozitive, si dhe ndërprerjet e shpeshta të procesit mësimor për shkak të gjendjes së luftës - të gjitha këto kanë ndikuar në degradimin e vazhdueshëm të cilësisë, duke dëmtuar gjenerata të tëra të nxënësve dhe studentëve. Për shkak të rrethanave të tilla, një numër i konsiderueshëm i fëmijëve dhe të rinjve nuk e kanë ndjekur shkollën, gjë që shihet edhe nga trendi i vazhdueshëm i zvogëlimit të numrit të nxënësve dhe studentëve në periudhën 1992-1999, e që është ndryshuar vetëm në periudhën e pasluftës.

Periudha e pasluftës ka sjellë një përmirësim të dukshëm në kuptim të krijimit të kushteve për punë normale, por jo edhe përmirësim të cilësisë. Autoritetet ndërkombëtare, të cilat kanë pasur autorizime të plota për qeverisjen e sistemit të arsimit në periudhën 1999-2002, kanë nxitur disa reforma që nuk kanë dhënë rezultate të dëshiruara. Njëra prej tyre është kalimi i arsimit të lartë në Sistemin e Bolonjës, që është bërë pa përgatitje të duhura përmes shkurtimit mekanik të programeve të studimit nga 4 në 3 vjet, hapjen e dhjetëra programeve të reja baçelor dhe master pa staf akademik të kualifikuar dhe në forma të tjera krejtësisht joadekuate. Në këtë periudhë, me vendim të UNMIK-ut, është hequr nga sistemi shërbimi pedagogjik në shkolla, si dhe janë mbyllur Enti Pedagogjik i Republikës së Kosovës dhe entet pedagogjike komunale, duke i zëvendësuar ato me struktura krejtësisht joefektive të mbështetjes profesionale dhe mbikëqyrjes.

Degradimi ka vazhduar edhe pas marsit të vitit 2002, kur përgjegjësitë për menaxhimin e sistemit të arsimit i morën vendorët. Gjatë kësaj periudhe u aprovua legjislacioni i ri për arsimin, si dhe dokumente të shumta strategjike për zhvillimin e arsimit, prej të cilave më të rëndësishmet janë:

²³ UNICEF. (1999). Education Situation Report No. 1 - Bringing children back to school in Kosovo. Prishtina: UNICEF.

²⁴ Hyseni H., Shatri B., Salihaj J., Pupovci D.: Shifra dhe fakte për arsimin e Kosovës, KEC, Prishtinë, 2000.

- Strategjia e MASHT-it 2003 - 2008 – dokumenti i parë strategjik që përcakton prioritetet afatmesme për gjithë sistemin e arsimit;
- Strategjia e zhvillimit të arsimit të lartë në Kosovë 2005-2015;
- Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007-2017;
- Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016, i cili i zëvendësoi dy strategjitë në fuqi: për arsimin e lartë dhe atë parauniversitar;
- Plani strategjik i arsimit në Kosovë 2017-2021.

E përbashkëta e këtyre strategjive është synimi për të ofruar një kornizë për zhvillimin e arsimit në përputhje me praktikat më të mira evropiane dhe rajonale. Përveç strategjisë së parë, të gjitha të tjerat kanë plane veprimi me kosto të përcaktuar, ndërsa janë hartuar nga grupe ekspertësh vendorë dhe ndër-kombëtarë, me pjesëmarrje të gjerë të të gjitha palëve me interes. Përkundër faktit se të gjitha dokumentet strategjike janë miratuar nga Qeveria e Kosovës, ka pasur një shpërputhje të madhe ndërmjet planifikimit dhe zbatimit. Të shumtën e rasteve, Qeveria nuk ia dalë që prioritetet strategjike t'i bëjë pjesë të programeve qeverisëse dhe t'i mbështesë me buxhet. Në vend të kësaj janë bërë veprime *ad hoc* që nuk parashihen në asnjë dokument strategjik, duke bërë kalkulime politike për sigurimin e votave dhe realizimin e interesave të tjera. Një shembull tipik është hapja e 6 universiteteve publike për të cilën nuk bëhet fjalë në asnjërin nga këto dokumente, ku parashihen masat për sigurimin e cilësisë dhe respektimi i kriterëve akademike, e jo masivizimi i pakontrolluar i arsimit të lartë. Shembulli tjetër është rritja e pagave të personelit arsimor në kohë të fushatave dhe kjo bie ndesh me përcaktimet strategjike që mësimdhënësit të paguhën në bazë të performancës.

Në kushte normale, për progresin e zbatimit të një politike gjykohet në bazë të shkallës së arritjes së caqeve të përcaktuara dhe politikëbërësit duhet të angazhohen shumë për të demonstruar progresin. Në një shoqëri transitore siç është Kosova, ku vetëdija për përgjegjësinë publike është në nivel të ulët, ndodh shpesh që të bëhet e kundërta e asaj që është proklamuar, pa pasoja për vendimmarrësit.

Në vitin shkollor 2019/20 në Kosovë kanë funksionuar gjithsej 1.094 institucione edukative-arsimore publike të nivelit parauniversitar, prej të cilave 44 institucione parashkollore, 927 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, si dhe 123 shkolla të mesme të larta.²⁵ Në sektorin privat kanë operuar 159 institucione parashkollore²⁶

²⁵ Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20. MASHT. 2020.
https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/statistikat-e-arsimit-2019-2020_1.pdf

²⁶ Lista e institucioneve parashkollore të licencuara.
<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/05/lista-e-fundit-26082020-1.doc>

dhe 28 shkolla fillore dhe të mesme.²⁷ Krahas tyre kanë operuar edhe 9 institucione publike dhe 23 institucione private të arsimit të lartë.

Tabela 1 jep të dhëna për numrin e fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në nivele të ndryshme të sistemit arsimor në pesë vitet e fundit. Nga tabela vërehet se ka rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes në nivelin e edukimit parashkollor, si dhe zvogëlim të numrit të nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët, ndërkaq në tri vitet e fundit edhe në arsimin e mesëm të lartë dhe në arsimin e lartë. Ky është rezultat i drejtpërdrejtë i rritjes së mundësive për pjesëmarrje në edukimin parashkollor, i zvogëlimit të popullsisë dhe zvogëlimit të interesimit për studime të larta.

Tabela 1. Numri i fëmijëve, nxënësve dhe studentëve në institucionet edukative-arsimore të Kosovës²⁸

Treguesi	2015/16	2016/17	2017/18	2018/19	2019/20
Numri i fëmijëve në edukimin parashkollor	26.924	28.986	30.638	32.084	34.042
Numri i nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët	261.107	250.931	244.677	239.937	234.590
Numri i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë	86.376	89.392	89.714	84.249	77.908
Numri total i fëmijëve - nxënësve në arsimin parauniversitar	374.407	369.309	365.029	356.270	345.540
Numri total i studentëve në arsimin e lartë	120.429	123.988	116.424	104.513	
Gjithsej fëmijë, nxënës dhe studentë në sistemin e arsimit	494.836	493.297	481.453	460.783	

²⁷ Lista e institucioneve të licencuara parauniversitare.

<https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/04/institucioni-parauniversitar-14082020.docx>

²⁸ MASHT: Raporti i vlerësimit të Planit strategjik të arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019, Prishtinë, gusht 2020. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/09/raporti-psak-2019-alb-1.pdf>

3.2. Sfidat e përgjithshme

3.2.1. Qeverisja dhe llogaridhënia

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Kosova ka një sistem të decentralizuar të arsimit parauniversitar, prandaj autoriteti për menaxhimin e institucioneve arsimore u takon komunave. Ndërkaq pushtetit qendror i mbetet kompetenca për bërjen e politikave të arsimit, financimin dhe inspektimin. Në fakt modeli i decentralizuar i arsimit parauniversitar është krijuar në vitin 2008 si pjesë e Pakos së Ahtisaarit, me motiv të qartë që të sigurohet më shumë autonomi veprimi për komunat me shumicë serbe. Brenda këtij sistemi institucionet arsimore kanë shumë pak autonomi menaxhuese, përderisa komunat gëzojnë të drejtën e punësimit të personelit dhe emërimit të drejtorit të institucionit. Shkollat kanë këshilla drejtuese, por autorizimet e tyre janë të kufizuara.

Përderisa një model i tillë funksionon mirë për nivelin e edukimit parashkollor dhe të arsimit të obligueshëm, situata me arsimin e mesëm të lartë është ndryshe. Autoriteti i komunave që t'i udhëheqin dhe menaxhojnë gjimnazet dhe shkollat profesionale e ka bërë shumë të vështirë mundësinë e lëvizjes së nxënësve nga një komunë në tjetrën, prandaj kjo është bërë shkas që disa komuna të vogla të formojnë gjimnaze ose profile të caktuara të arsimit profesional edhe atëherë kur nuk kanë kushte infrastrukturore dhe profesionale për diç të tillë. Po ashtu, komunat janë shumë rigide në ndryshimin e profileve në shkolla profesionale, për të mos hapur problemin e tepërave teknologjike të personeli mësues.

Komunat janë punëdhënëse të rreth 45 mijë qytetarëve, përderisa shkalla e papunësisë vazhdon të jetë e lartë – 25.7 për qind në vitin 2019. Për këtë arsye punësimi në këtë nivel ndërlikohet shpesh me raportin e forcave në skenën politike lokale dhe rezultojnë krijimin e raporteve klienteliste brenda komunave. Kjo manifestohet edhe në punësimin e personelit mësues në shkolla dhe sidomos në emërimin e drejtorëve të shkollave, që është kompetencë e drejtpërdrejtë e kryetarëve të komunave.

Për dallim nga institucionet e nivelit parauniversitar, institucionet publike të arsimit të lartë gëzojnë një shkallë të lartë të autonomisë në marrjen e vendimeve menaxheriale dhe autonomi të plotë akademike. Interesat e shtetit përfaqësohen përmes anëtarëve të emëruar të këshillave drejtuese, të cilët përbëjnë pakicën në këto organe në raport me anëtarët që zgjedhen nga vetë institucioni, si dhe përmes ushtrimit të disa kompetencave ligjore siç është miratimi i statuteve, dhënia e pëlqimit për kuotat e studentëve, aprovimi i buxhetit e të ngjashme.

Përderisa ndërhyrjet politike në nivelin parauniversitar bëhen përmes strukturave komunale, në institucionet e arsimit të lartë ato bëhen përmes Ministrisë së Arsimit, si dhe nga grupet e interesit brenda institucionit, duke ndikuar në zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues, të senatit, dekanëve të fakulteteve, madje edhe në zgjedhjet studentore. Mobilizimi i strukturave politike është evident në kohën e zgjedhjeve në institucione të arsimit të lartë, kur me metoda të ndryshme që nuk kanë asgjë të përbashkët me botën akademike ushtrohet ndikimi për emërimin e personave të afërt me grupimet e ndryshme politike ose grupimet joformale brenda universiteteve. Me veprime të tilla ndikohet në punësimet dhe angazhimet e stafit në universitete publike, ku është bërë e zakonshme të akomodohen bartës të funksioneve të larta publike, deputetë e ministra, të cilët kualifikimet akademike i kanë fituar gjatë ushtrimit të funksionit, me përkrahje joparimore të një pjese të stafit akademik të etur për favore e privilegje. Ndërhyrja politike e vazhdueshme ka ndikuar në krijimin e disa praktikave korruptive siç janë: regjistrimet e paligjshme të studentëve, tolerimi i punësimit të shumëfishtë, pagesat enorme të stafit menaxhues, etj. Ky lloj ndikimi e ka shndërruar skenën e arsimit të lartë në fushëbetejë dhe fushëpërplasjeje midis klaneve politike e financiare, me një vrazhdësi të tillë e cila i demotivon profesorët e mirëfilltë që të përpiqen për ndryshime dhe t'i rezistojnë ndërhyrjes së politikës. Demotivimin e shkakton edhe diskursi publik agresiv përplot përgjithësime dhe thjeshtëzime për botën akademike. Meqenëse mësimdhënësit me integritet i shmangen përbaltjes populliste, por kështu u hapet rruga shërbyesve të politikës që marrin poste udhëheqëse në arsimin e lartë.

Konteksti i përshkruar relativizon dukshëm institucionin e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit. Kështu, drejtori i një institucioni arsimor parauniversitar i përgjigjet kryetarit të komunës i cili e ka emëruar dhe jo komunitetit të cilit i shërben institucioni. Meqë performanca e shkollave nuk është kriter dominues për përcaktimin e votuesve në zgjedhje, strukturat e pushtetit lokal nuk bëjnë shumë përpjekje që përmes politikës së drejtë kadrovike dhe ofrimit të mbështetjes së nevojshme profesionale e logjistike të sigurojnë mirëfunksionimin e tyre. Nga ana tjetër, niveli qendror i përfaqësuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nuk ndërmerr masa të duhura për të nxitur përgjegjësinë dhe llogaridhënien në institucionet arsimore parauniversitare, që do të mund të bëhej përmes inspektimit cilësor dhe sigurimit të besueshmërisë së testeve kombëtare, të cilat, për shkak të kopjimit masiv, rëndom japin pasqyrë të gabuar për performancën e shkollave.

E njëjta gjë vlen edhe për institucionet publike të arsimit të lartë. Financimi i tyre nga shteti nuk bëhet mbi bazën e një plani të performancës, i cili do të mundësonte monitorimin e punës së tyre dhe do t'i nxiste ato të kultivojnë kulturën e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies. Përkundrazi, menaxhmentet e këtyre institucioneve shpesh thirren në autonomi kur u kërkohet llogari për punën e tyre,

ndërkohë që nuk hezitojnë të kërkojnë mbështetjen e strukturave politike për të siguruar trajtim të privilegjuar të institucioneve të tyre, sidomos në raport me procesin e akreditimit.

Zgjidhja

Është e domosdoshme që në Kosovë **të instalohet një sistem i mirëfilltë i përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet, përfshirë institucionet arsimore, pushtetin lokal dhe institucionet qendrore.** Institucioni arsimor nuk mund të thirret në përgjegjësi për rezultatin e punës së vet nëse nuk ekziston një sistem i besueshëm i mbikëqyrjes, ndërtimi i të cilit është obligim i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në veçanti, shkolla nuk mund të mbahet përgjegjëse për dështimet eventuale nëse në vazhdimësi i mungon mbështetja profesionale dhe logjistike nga komuna nën autoritetin e së cilës operon, ose nëse komuna sjellë në shkollë mësimdhënës dhe drejtorë që nuk janë në nivelin e detyrës. Prandaj kërkimi i përgjegjësisë dhe llogaridhënies duhet të fillojë nga organet më të larta të pushtetit qendror dhe lokal, të cilat duhet të sigurohen se vendimet i marrin në bazë të të dhënave dhe praktikave më të mira, se i zbatojnë politikat dhe legjislacionin e miratuar, se nuk ndikohen nga interesat politike, partiake e biznesore, se përballen me pasojat me rastin e dështimeve. Këtë mund ta jetësojë një lidërsip i përgjegjshëm në nivelin qendror dhe lokal që nuk e ka interes primar përfitimin personal dhe rezultatin në zgjedhjet e radhës, por interesin e qytetarëve dhe të vendit.

Kosova ka një traditë të sistemit arsimor të decentralizuar dhe, në këtë kuptim, edukimi parashkollor dhe arsimi i obligueshëm duhet të mbeten nën autoritetin e pushtetit lokal. Ndërkaq, duke marrë parasysh madhësinë e territorit dhe devijimet e deritanishme, duhet **të shqyrtohet me seriozitetin më të madh dhe me urgjencë mundësia që arsimi i mesëm i lartë të vihet nën autoritetin e drejtpërdrejtë të pushtetit qendror.** Kjo do të bënte të mundur një racionalizim të rrjetit të shkollave të mesme të larta që do të ishte në funksion të ngritjes së cilësisë në këtë nivel të arsimit.


Në arsimin e lartë duhet marrë masa për minimizimin e ndikimit politik në favor të meritokracisë, duke **rishikuar rregullativën ligjore dhe statutet e IAL-ve publike.** Institucionet e arsimit të lartë duhet të marrin financimin publik në bazë të marrëveshjeve me Qeverinë, të cilat përmbajnë pritje të qarta për performancën e tyre dhe shërbejnë si bazë për monitorim të vazhdueshëm, duke ndikuar në rritjen e përgjegjësisë dhe të llogaridhënies.

3.2.2. Financimi i arsimit

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Shpenzimet publike për arsim në vitin 2018 kanë qenë 4.2 për qind e BPV-së,²⁹ që është nën mesataren e BE-së prej 4.7 për qind, por mbi nivelin e disa vendeve të BE-së si Rumania (3.2 për qind), Bullgaria (3.5 për qind), Greqia (3.9 për qind) e Sllovakia (4.0 për qind), si dhe mbi nivelin e vendeve fqinje si Shqipëria e Serbia nga 3.9 për qind ³⁰ siç është paraqitur te Figura 4.

Figura 4. Shpenzimet publike në arsim në raport me BPV-në



Me gjithë rritjen e vazhdueshme të shumës nominale të shpenzimeve për arsim, vërehet një rënie e shpenzimeve si përqindje e BPV-së dhe si përqindje e shpenzimeve të përgjithshme të Qeverisë. Kështu, në vitin 2015 shpenzimet e përgjithshme për arsim kanë qenë 261.9 milion euro (4.5 për qind e BPV-së dhe 16.2 për qind e shpenzimeve qeveritare), ndërsa në vitin 2018 – 285.9 mil. euro (4.2 për qind e BPV-së dhe 13.7 për qind e shpenzimeve qeveritare).³¹ Rritja e moderuar e buxhetit për arsim ka të bëjë me rritjen e pagave, të cilat dominojnë në

²⁹ Ministria e Financave, Republika e Kosovës; Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2018-2020

³⁰ <https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34432/152967.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

³¹ J. Aliu etj.: Menaxhimi i arsimit parauniversitar në Kosovë, KEC-KEEN, dhjetor 2018. https://keen-ks.net/site/assets/files/1456/raporti_per_menaxhimin_e_arsimit_parauniversitar_-_alb.pdf

strukturën e shpenzimeve. Vendimet për rritje të pagave janë marrë kryesisht në kohën e fushatave zgjedhore dhe me qëllime të qarta politike, pa ndonjë analizë të efektivitetit të veprimeve të tilla. Vetëm në periudhën 2009-2012 pjesëmarrja e pagave në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët është shtuar nga 85 për qind në 92 për qind të buxhetit të përgjithshëm për këto nivele të arsimit.³² Një politikë e tillë ka bërë që fondet për shpenzime kapitale dhe rrjedhëse në institucione arsimore të zvogëlohen dukshëm, duke ndikuar në përkeqësimin e kushteve të punës, sidomos në nivelin parauniversitar.

Financimi i institucioneve arsimore parauniversitare bëhet nga granti specifik i arsimit, i cili përcaktohet sipas një formule të nivelit qendror. Ky sistem funksionon me shumë probleme, pasi formula nuk është adekuate për të gjitha llojet e shkollave dhe rrethanat në të cilat ato operojnë. Nga ana tjetër, nuk ka një sistem që garanton efektivitetin e financimit. Në realitet, ndodh shpesh të financohen shkolla me pak nxënës, ekzistimi i të cilave nuk është aspak i arsyeshëm, pasi në afërsi operojnë shkolla gjysmë të zbrazëta që ofrojnë kushte shumë më të mira për arsimim.

Sa i përket arsimit të lartë, qeveria është financuesi kryesor i IAL-ve publike, derisa burimet e tjera janë nga pagesat e studentëve, shërbimet e ofruara etj., ndërkaq sektori privat financohet kryesisht nga pagesat e studentëve. Buxhetet për 6 universitetet publike ndahen në shumë prej 2-3 milionë euro për secilin, pa përfshirë Universitetin e Prishtinës i cili ka buxhet prej 34 milionë euro.³³ Ky buxhet është jashtëzakonisht i ulët në krahasim me universitetet e tjera të Rajonit, si Universiteti i Lubjanës me buxhet rreth 290 milionë euro, Universiteti i Zagrebit me rreth 330 milionë, Universiteti i Beogradit me 160 milionë dhe Universiteti i Sofjes me 120 milionë.

Ligji për arsimin e lartë parasheh hartimin e akteve nënligjore për formulën e financimit, mirëpo një gjë e tillë ende nuk është realizuar. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, sidomos ato publike, nuk kanë dëshmuar qëndrueshmëri financiare. Mungesa e mjeteve buxhetore shtesë të universiteteve publike nuk e mbështet implementimin e planeve të performancës, duke bërë që shumica e objektivave të tyre të deklaruara të mos jenë reale dhe të arritshme. Në anën tjetër në IAL-të publike të Kosovës mungojnë nisma për të diversifikuar burimet e financimit, p.sh. përmes projekteve të ndryshme ndërkombëtare apo kapacitete për të tërhequr fonde të hulumtimit, çka penalizon në vazhdimësi zhvillimin e cilësisë së programeve të tyre.

³² Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PLANI_STRATEGJIK_I_ARSIMIT_NE_KOSOVE.pdf

³³ Ligji për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018 Nr. 06/L-020
<https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/668E7D87-490C-4229-881B-E66CE614F4C1.pdf>

Mbetet brengosës fakti se një përqindje e lartë (rreth 75 për qind) e buxhetit të IAL publike shpenzohet për paga të stafit, ndërsa krijimi i të ardhurave është ende shumë larg nga nivelet që arrijnë IAL në vende të Europës.

Zgjidhja

Ndërtimi i një sistemi efektiv dhe llogaridhënës të financimit i bazuar në parimet e menaxhimit të mirë të parasë publike është parakusht për mirëfunksionimin e institucioneve arsimore. Sistemi i tillë **nuk duhet të lejojë që të financohen institucione arsimore ose programe mësimore arsyjeja e vetme e ekzistimit të të cilëve është mbajtja e personelit në listat e pagave ose krijimi artificial i vendeve të punës** brenda sistemit të arsimit që, të shumtën, nuk i kontribuojnë zhvillimit të arsimit, por ndërtimit të raporteve klienteliste në shoqëri. Po ashtu buxheti për arsim nuk guxon të jetë i dominuar nga pagat, pa lënë hapësirë për shpenzime të nevojshme kapitale dhe rrjedhëse.

IAL-të publike duhet **të ndërmarrin masa të menjëhershme për rritjen e sasisë së mjeteve të krijuara vetanake**, duke siguruar një shkallë më të lartë pavarësie nga fondet publike. Këto mjete financiare duhet të krijohen përmes pjesëmarrjes në projekte kërkimore e zhvillimore, shërbimeve, organizimit të kurseve të mësimi gjatë gjithë jetës, etj.

Financimi i institucioneve publike të arsimit të lartë duhet të bëhet ashtu si parashihet në Ligj,³⁴ përmes marrëveshjeve të performancës të bazuara në objektiva të përcaktuara.

3.2.3. Teknologjia e informacionit dhe komunikimit

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Sipas raportit të shtatorit 2020 nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP)³⁵ në Kosovë shkalla e penetrimit të internetit për shtëpi është 115 për qind dhe penetrimi i telefonisë mobile³⁶ është 101 për qind, që janë tregues më të mirë se mesatarja e vendeve të Bashkimit European.

³⁴ Ligji nr.04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

³⁵ http://arkep-rks.org/repository/docs/Pasqyrapërqind20epërqind20tregutpërqind20tepërqind-20KEpërqind20_Indikatoretpërqind20kryesorpërqind20perpërqind20TM2përqind2020202109.pdf

³⁶ Në lidhje me Internetin, i bie që secila ekonomi familjare ka Internet dhe disa e kanë edhe nga një shtesë, pra 21.9% të ekonomive familjare i kanë nga dy burime të Internetit. Ngjashëm edhe tek telefonja mobile, të gjithë e kanë nga një numër mobil, por disa (10%) i kanë nga dy numra.

Edhe pse plani i Qeverisë³⁷ parasheh që “shkolla është qendër e avancuar teknologjike, ku duhet të zbatohen teknologjitë moderne digjitale arsimore në mësimdhënie dhe mësimnxënie për të pasur rezultate të mira” në praktikë, kjo është larg nga e vërteta, sepse mesatarisht në Kosovë ka 1 kompjuter (PC) për 37.5 nxënës.³⁸ Kështu del një shpërputhje e madhe mes ambientit teknologjik në shtëpi dhe atij në shkollë, gjë që e bën ambientin shkollor më refuzues për mësimnxënie. Për më shumë, veprimet për arsim digjital, konformë planit të veprimit të BE-së nga viti 2018 nuk janë të reflektuara në dokumentet dhe planet e Qeverisë së Kosovës.

Edhe shkathtësitë e mësimdhënësve kanë nevojë të zhvillohen në përputhje me teknologjinë si vegël ndihmëse në secilën lëndë mësimore, siç është përcaktuar me Kornizën europiane të kompetencës digjitale për mësimdhënës,³⁹ ku janë definuar 6 fusha të kompetencës që duhet t’i zotërojnë mësimdhënësit.

Aktualisht lënda e Teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) është e nivelit aplikativ sipërfaqësor dhe nuk reflekton mendimin kreativ dhe programimin (kodimin) si shkathtësi kryesore në TIK. Teknologjitë ose gjuhët programuese (kodimi), që mësohen në shkollën e mesme të lartë janë të vjetra dhe joatraktive për shkollimin e mëtutjeshëm ose për tregun e punës.

Zgjidhja

Me qëllim që Kosova të shfrytëzojë epërsinë që e ka ndaj vendeve fqinje me popullsinë e re dhe penetrimin e lartë mbi 100 për qind të internetit nëpër shtëpi, duhet që:

Kodimi të futet si lëndë (koncept, logjikë dhe filozofi) e veçantë në kurikulat shkollore që nga klasa VI. Interneti po e ndryshon jo vetëm mënyrën se si jetojmë, por edhe si punojmë dhe tani janë me miliona punë të hapura të cilat kërkojnë përvojë, aftësi dhe shkathtësi të kodimit. Tanimë janë zhvilluar platforma teknologjike të shumta që u mundësojnë këtyre grup-moshave t’i përvetësojnë këto shkathtësi.

Të bëhet digjitalizimi i të gjitha proceseve mësimore – veglat dhe platformat e përdorura gjatë pandemisë duhet të institucionalizohen (GoogleClassroom, GoogleMeet, Zoom, MicrosoftTeams etj.), siç janë përcaktuar në fushën e 2 dhe 3 të Kompetencave digjitale të BE-së (DigCompEdu) si dhe të shmangen punët e tepërta administrative (me letra) dhe përmbajtjet mësimore të digjitalizohen ashtu që ndërveprimi digjital të jetë më i lehtë, fusha 1 e Kompetencave digjitale të BE-së.

³⁷ <https://kryeministri-ks.net/wp-content/uploads/2020/06/Programi-Qeverises-2020-2023-final-05062020.pdf>

³⁸ Jusuf Thaci – Analiza e gjendjes për digjitalizim.

³⁹ <https://ec.europa.eu/jrc/en/publication/eur-scientific-and-technical-research-reports/european-framework-digital-competence-educators-digcompedu>

Ditari digjital, fusha 4 e Kompetencës digjitale të BE-së do të ishte vetëm një shembull i natyrshëm i integritit të prindërve në përcjelljen e suksesit të fëmijëve. **Secili mësimmhënës të pajiset me laptop ose tablet**, sepse pajisjet e duhura janë parakusht edhe për digjitalizimin e materialeve dhe proceseve mësimore. Shënimet për aktivitetet në klasë dhe jashtë saj të ruhen në formë digjitale ashtu që komunikimi digjital me nxënës dhe prindër do të ishte shumë më i lehtë. Mësimmhënësit, me pajisje të duhura, do të mund të kryenim edhe shumë aktivitete të tjera të vlerësimit dhe përcjelljes së nxënësve edhe nga shtëpia, konform Kornizës europiane të kompetencës digjitale për mësimmhënësit (DigCompEdu).

3.2.4. Arsimi në funksion të punësimit dhe zhvillimit

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Zhvillimi i shpejtë i teknologjisë dhe nevoja për fuqi punëtore të kualifikuar e ka shndërruar arsimin në mjet për arritjen e një qëllimi utilitar dhe t'i orientuar kah tregu i punës. Me pak fjalë, arsimi shihet si përgatitje e individit për përfshirje në tregun e punës përmes së cilës i kontribuon edhe zhvillimit ekonomik të vendit. Kjo dallon nga koncepti i arsimit si qëllim më vete, i cili ka për detyrë ta pajisë njeriun me njohuri dhe shkathtësi bazike që i mundësojnë të mësojë në mënyrë të pavarur gjatë gjithë jetës, duke i kontribuar ndërtimit të vlerave të qytetarisë demokratike. Përveç punëtorëve të kualifikuar dhe ekspertëve të ardhshëm, arsimi nxjerr edhe njerëz që duhet të jenë të gatshëm për pjesëmarrje në jetën politike, qoftë në cilësinë e votuesit ose të zgjedhurit të popullit, duke marrë vendime që janë në dobi të shoqërisë dhe të shtetit. Për këtë arsye arsimi asnjëherë nuk mund të trajtohet vetëm nga këndvështrimi i ndërlidhjes me tregun e punës.

Në nivel deklarativ Qeveria e Kosovës i qëndron besnike konceptit të arsimit si mjet për arritjen e qëllimit utilitar, duke vënë zhvillimin e kapitalit njerëzor si një nga katër shtyllat të Strategjisë kombëtare të zhvillimit 2016-2021.⁴⁰ Në këtë dokument bazë kapitali njerëzor shihet nga këndvështrimi i efikasitetit dhe dobisë së tij për nxitjen e zhvillimit ekonomik, ngjashëm si kapitali fizik (makinat, infrastruktura, etj.). Edhe Banka Botërore⁴¹ përqendrohet në zhvillimin e kapitalit njerëzor, duke nxjerrë parashikimin se fëmijët e lindur sot në Kosovë, në kohën kur i mbushin 18 vjet, do të jenë 43 për qind më pak produktivë në tregun e punës sesa fëmijët që gëzojnë

⁴⁰ Strategjia Kombëtare e Zhvillimit 2016-2021.
http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Strategjia_Kombetare_per_Zhvillim_2016-2021_Shqip.pdf

⁴¹ World Bank Group: Human Capital Index 2020 Update.
<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34432/152967.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

arsim të plotë dhe shëndet të mirë.⁴² Sipas raportit të Bankës Botërore, Kosova ka indeksin e kapitalit njerëzor 0.57 dhe ndodhet nga mesi i tabelës së shteteve të botës, së cilës i prin Singapori me indeks 0.89. Nga vendet e Ballkanit Maqedonia e Veriut ndodhet prapa Kosovës me indeks 0.56, ndërkaq para Kosovës janë Bosnja dhe Hercegovina me indeks 0.59, Bullgaria me 0.62, Mali i Zi dhe Shqipëria me 0.64, Turqia me 0.66, Serbia me 0.69 dhe Greqia me 0.70.⁴³

Arsimi i mesëm profesional është niveli i parë i përgatitjes së të rinjve për tregun e punës. Përkundër faktit se vazhdon të jetë zgjedhja e dytë për shumicën e atyre që mbarojnë shkollimin e obligueshëm, rreth 52 për qind e nxënësve të shkollave të mesme vijnë në mësimin në njërin nga 140 profilet që kanë për qëllim përgatitjen e tyre për tregun e punës. Ky qëllim nuk arrihet gjithnjë për faktin se lidhja e arsimit profesional me ekonominë vazhdon të jetë e dobët, në radhë të parë për shkak të mospërshtatjes së profileve me kërkesat e tregut të punës dhe mungesës së punës praktike gjatë shkollimit. Kështu, mbi 28 për qind të nxënësve të regjistruar në shkollat profesionale në vitin 2018/19⁴⁴ kanë qenë në profile ekonomike, juridike dhe administrim biznesi, ndërsa mbi 18 për qind në profile shëndetësore të cilat mundësitë e punësimit pas mbarimit të shkollës së mesme janë më se të kufizuara. Vendimet për hapjen e profileve të caktuara merren pa ndonjë analizë të mirëfilltë të nevojave, duke shkaktuar kështu tepricë të panevojshme në tregun e punës. Një shembull për këtë është Komuna e Junikut ku operon paralelja e ndarë e shkollës së mesme të mjekësisë në Gjakovë me disa profile shëndetësore, edhe pse në këtë komunë nuk ka kushte për zhvillimin e punës praktike. Komunat janë shumë rigide në ndryshimin e profileve në shkolla profesionale për të mos hapur problemin e tepercave teknologjike të personeli mësimor.

Nga ana tjetër, në treg ka mungesë të theksuar të punëtorëve të kualifikuar të disa profileve të zejeve, industrisë dhe bujqësisë. Profile të caktuara vazhdojnë të ofrohen edhe në ato shkolla dhe komuna ku nuk ka kushte elementare për zhvillimin e punës praktike në biznese, duke thelluar kështu shpërputhjen ndërmjet shkathtësive që kërkon tregu i punës dhe atyre që zhvillon shkolla. Kjo shpërputhje konsiderohet nga bizneset si një ndër faktorët kryesorë që frenon zhvillimin e tyre.

Situatë e ngjashme mbizotëron edhe në arsimin e lartë, sepse ekziston një tendencë e regjistrimit të studentëve në programe për të cilat tanimë ka tepricë në tregun e punës. Kështu, në vitin akademik 2018/19 nga 29.284 studentë të

⁴² Konsiderohet se fëmijët e një vendi gëzojnë arsim të plotë dhe shëndet të mirë, nëse plotësohen këto kushte: 1) 100 për qind e fëmijëve të lindur e mbërrijnë moshën 5 vjet; 2) fëmijët arrijnë numër maksimal të pikëve nga testet ndërkombëtare në shkallën e normuar prej 300-625; 3) 100 për qind e fëmijëve të moshës 15 vjet e mbërrijnë moshën 60 vjeçare; 4) 100 përqind e fëmijëve të moshës nën 5 vjet kanë rritje normale.

⁴³ World Bank Group: Human Capital Index 2020 Update.

<https://openknowledge.worldbank.org/bitstream/handle/10986/34432/152967.pdf?sequence=1&isAllowed=y>

⁴⁴ D. Pupovci: Torino Process 2018–2020, National report Kosovo, Prishtina, 2019.

regjistruar për herë të parë në IAL-të e Kosovës, 22.8 për qind kanë zgjedhur programet e biznesit, 15.3 për qind programet shëndetësore, 12.7 për qind janë regjistruar në programe nga fusha e drejtësisë; 19.1 për qind në shkenca shoqërore e humane, në edukim dhe arte, ndërsa 20 për qind në shkenca të natyrës, në matematikë, informatikë dhe inxhinieri.⁴⁵ Fakti se 34.5 për qind e studentëve të rinj regjistrohen në programe nga fusha e biznesit dhe drejtësisë mund të shpjegohet pjesërisht me ofertën e programeve të tilla në sektorin publik, ku operojnë pesë fakultete juridike e pesë fakultete ekonomike, si dhe në atë privat, ku pothuajse secili kolegji ka programe nga këto fusha. Mirëpo, nga ana tjetër, në shumë programe të tjera që ofrojnë perspektivë më të mirë punësimi numri i studentëve nuk plotësohet. Ndërkaq, numri i madh i studentëve në programe shëndetësore ndërlidhet me perspektivat e punësimit në vende të BE-së, ku ekziston kërkesë e vazhdueshme për profile të tilla.

Përveç mungesës së profilizimit, një defekt i institucioneve të arsimit të lartë është mospërshtatja e përmbajtjes së programeve me kërkesat e tregut të punës dhe mosorganizimi i punës praktike për studentë. E para lidhet me komunikimin jo të rregullt të IAL-ve me punëdhënësit dhe industrinë. Në disa IAL ekzistojnë trupa këshillëdhënës, të cilët duhet t'i kontribuojnë përshtatjes së programeve me kërkesat e tregut, por roli i tyre është shpesh formal, ndërkohë që në një ekonomi ku dominojnë mikrondërmarrjet edhe punëdhënësit nuk janë në gjendje t'i definojnë nevojat e tyre për shkathtësi. Ndërkaq, mungesa e punës praktike të shumtën e ka burimin në qasjen formale të IAL-ve ndaj përgatitjes së studentëve për tregun e punës. Në fakt shpesh ndodh që studentët të cilët vijnë nga shkollat profesionale kanë bërë praktikë më cilësore gjatë shkollimit të mesëm sesa në studime universitare. Shkaktar i kësaj mund të jetë numri i madh i studentëve në grupe dhe mënyra se si kuptohet puna praktike në IAL, por edhe lidhjet e dobëta me ekonominë në ato raste kur puna praktike duhet të zhvillohet në stabilimente industriale. Rezultati përfundimtar i gjithë kësaj janë të diplomuarit që nuk janë të përgatitur për ushtrimin e profesionit të tyre.

Në fakt arsimi i lartë në Kosovë aktualisht ka synim të prodhojë numra me të cilët mund të bëjnë fushata politikanët, ndërsa nuk ka synim të krijojë intelektualë nga të cilët përfiton shoqëria. Harrohet se arsimi i lartë nuk i përgatitë studentët vetëm për tregun e punës, por e zhvillon dhe e përkufizon identitetin e tyre dhe të shoqërisë. Për shkak të numrit të madh të studentëve, ky rol shoqëror i arsimit të lartë po bëhet gjithmonë e më i parëndësishëm dhe po e humb funksionin.

⁴⁵ MASH: Raporti i vlerësimit të Planit strategjik të arsimit në Kosovë 2017-2021 për vitin 2019, gusht 2020. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/09/raporti-psak-2019-alb-1.pdf>

Zgjidhja

Synimet për ndërlidhje më të mirë të arsimit me tregun e punës në asnjë mënyrë nuk duhet ta instrumentalizojnë arsimin, duke e reduktuar në mjet që shërben për zhvillim ekonomik dhe punësim. Arsimi është shumë më tepër se aq dhe, në radhë të parë, i shërben zhvillimit të individit, pastaj zhvillimit ekonomik. Në fakt individi i kompletuar i ka të gjitha parakushtet që të jetë produktiv dhe t'i kontribuojë zhvillimit ekonomik. Prandaj **përmes programeve arsimore, përveç shkathtësive specifike që kërkohen nga tregu i punës, duhet të zhvillohen edhe kompetencat personale, siç është kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe kompetenca qytetare.**

Sa i përket ndërlidhjes ndërmjet arsimit dhe tregut të punës duhet të bëhet një **riorganizim i plotë i rrjetit të shkollave të mesme profesionale dhe profileve që ofrojnë ato, duke siguruar që të jenë në përputhje me kërkesat e tregut.** Shkollat e mesme profesionale duhet të ofrojnë programe të ndërlidhura ngushtë me standardet e profesioneve të caktuara, duke mundësuar transicion të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës. Profilet e caktuara nuk duhet të ekzistojnë në ato komuna ku nuk ka kapacitete për zhvillimin cilësor të mësimin teorik dhe praktik, por duhet t'iu mundësohet nxënësve të vijojnë mësimin në po ato profile në komunat e tjera. Kjo zgjidhet përmes procesit të akreditimit të shkollave profesionale dhe programeve që është obligim ligjor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve.

Edhe **oferta e programeve të arsimit të lartë në sektorin publik duhet të rishikohet** në mënyrë që me paratë e taksapaguesve të mos financohet papunësia strukturore. Pa asnjë dyshim, Kosova nuk ka nevojë për pesë fakultete juridike dhe pesë fakultete ekonomike në sektorin publik. Po ashtu **duhet përforcuar këshillimin dhe orientimin në karrierë** gjatë shkollës së mesme në mënyrë që nxënësit të jenë të vetëdijshëm për sfidat që i presin nëse përcaktohen për të studiuar në fushat që nuk ofrojnë perspektivë të mirë për punësim, gjithnjë duke pasur parasysh se vendimi për të studiuar një disiplinë paraqet kompromis mes dëshirave, prirjeve dhe mundësive individuale.

Si në arsimin profesional, ashtu edhe në atë të lartë duhet të **shtohet bashkëpunimi me punëdhënësit.** Kjo arrihet përmes fuqizimit të trupave këshillëdhënës brenda institucioneve arsimore prej të cilave pritet t'i artikulojnë më mirë nevojat e tregut të punës për shkathtësi specifike. Një bashkëpunim i tillë hap rrugën për një ndërveprim më të mirë ndërmjet arsimit dhe ekonomisë dhe krijon mundësi për kryerjen e punës praktike të nxënësve dhe studentëve në kompani, respektivisht institucione. Po ashtu institucionet arsimore **duhet të ndërmarrin studime gjurmuese** që japin informacion për punësimin e të diplomuarve dhe përshtatjen e programeve mësimore me kërkesat specifike të tregut të punës.

3.3. Arsimi parauniversitar

3.3.1. Pjesëmarrja në arsim

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Në periudhën e pasluftës Kosova ka shënuar përmirësim të dukshëm të pjesëmarrjes në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Ka vend për përmirësim edhe në arsimin e mesëm të lartë, ku nga aspekti i pjesëmarrjes Kosova qëndron më mirë se disa vende europiane si Sllovakia e Mali i Zi, por më keq se mesatarja europiane dhe vendet si Shqipëria, Serbia, Austria e Gjermania. Mirëpo gjendja më e keqe është në edukimin parashkollor, ku Kosova është prapa vendeve të tjera europiane, me përfshirje të vetëm 20 për qind të fëmijëve të moshës 0-6 vjet në çerdhe, kopshte dhe klasa parafillore. Gjendja është veçanërisht brengosëse te moshë 0-5, sepse vetëm 6.2 për qind të fëmijëve janë në çerdhe dhe kopshte. Përqindja shumë e ulët e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor dëshmon se ky nivel i edukimit dhe sfidat që lidhen me të nuk janë trajtuar asnjëherë seriozisht nga institucionet tona shtetërore. Në fakt të gjitha studimet tregojnë se edukimi parashkollor ka rëndësi të veçantë për zhvillimin e suksesshëm intelektual, akademik, social e emocional të fëmijëve në fazat e mëtutjeshme të shkollimit të jetës. Mospjesëmarrja në këtë nivel më së shumti dëmton fëmijët nga grupet sociale të marginalizuara, pasi familjet e tyre nuk kanë kushte që t’ua kompensojnë në mënyrë adekuate mosvijimin e formave të organizuara të edukimit në fëmijërinë e hershme. Kjo ka për pasojë përgatitjen jo të duhur për shkollimin e detyrueshëm, e cila ndikon në krijimin e hendekut ndërmjet kësaj kategorie të fëmijëve dhe të tjerëve, si dhe në performancë më të ulët gjatë shkollimit, duke thelluar kështu shtresimet sociale.

Situata me përfshirjen e grup-moshës 5-6 vjeç është më e mirë, pasi në kuadër të shumë shkollave fillore funksionojnë klasat parafillore. Sipas të dhënave të MASH rreth 92.5 për qind e fëmijëve të kësaj grup-moshe janë të përfshirë në arsimin parafillor, por duhet pasur parasysh se nevoja për pjesëmarrje në ndonjë formë të edukimit parashkollor lind shumë më herët. Bashkimi Europian shfrytëzon si masë të pjesëmarrjes në edukimin parashkollor përqindjen e fëmijëve të moshës 4 vjet deri në moshën e shkollimit të obligueshëm (në rastin e Kosovës moshë 4-6 vjet) të përfshirë në ndonjë formë të edukimit në fëmijërinë e hershme. Në Kosovë kjo pjesëmarrje është 49.5 për qind,⁴⁶ që është shumë më e vogël se pjesëmarrja në Bashkimin Europian me 95.3 për qind (2018).⁴⁷

⁴⁶ Mehmeti et al: Vlerësim afatmesëm: Zbatimi i Planit strategjik për arsimin në Kosovë 2017-2021, KEC-KEEN, nëntor 2019.

https://keen-ks.net/site/assets/files/1474/vleresim_afatmesem_i_psak_alb.pdf

⁴⁷ Eurostat: Participation in early childhood education by sex.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë vazhdojnë të mbesin grupi me më së shumti sfida, vështirësi e probleme sa i përket përfshirjes në arsimin parauniversitar, por edhe suksesit gjatë shkollimit. Përfshirja e fëmijëve të këtyre komuniteteve në edukimin parashkollor është jashtëzakonisht e ulët për arsye se, veç të tjerash, edukimi parashkollor është me pagesë dhe këto komunitete në përgjithësi jetojnë në kushte të vështira ekonomike. Sa i përket përfshirjes në shkollimin e detyrueshëm (klasat 1-9), të dhënat tregojnë se ka rënie graduale të përfshirjes së fëmijëve të këtyre komuniteteve gjatë niveleve të shkollimit. Përderisa në shkollimin fillor (klasat 1-5) përfshirja e nxënësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vlerësohet të jetë 85.3 për qind dhe kjo përqindje bie ndjeshëm në shkollimin e mesëm të ulët (klasat 6-9 në 65 për qind, ndërsa në shkollimin e mesëm të lartë në 30.3 për qind).⁴⁸ Rënia është rezultat i braktisjes së shkollimit nga këta nxënës, e cila ndodh për shkakë e arsye të ndryshme, kryesisht të ndërlidhura me gjendjen e rëndë ekonomiko-sociale të këtyre komuniteteve. Pjesëtarët e këtyre komuniteteve shpesh i nënshtrohen diskriminimit brenda sistemit arsimor, i cili manifestohet përmes segregacionit ose mosofrimit të mbështetjes së domosdoshme që të jenë të suksesshëm në shkollim, gjë që rezulton me braktisjen e shtuar dhe zvogëlimin e mundësive për punësim. E gjithë kjo bën që romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët të mbeten në marginat e zhvillimeve shoqërore në Kosovë, duke mos qenë të gjendje të dalin nga qarku i varfërisë, gjë që e pamundëson integrimin e tyre në shoqëri.

Grupi tjetër që ka nevojë për përfshirje me të lartë dhe përkujdesje të shtuar janë edhe nxënësit me nevoja të veçanta. Sipas të dhënave të MASH-it, në klasat e rregullta vijnë mësimin 3.903 nxënës me nevoja të veçanta, ndërsa në shkollat speciale 349 nxënës. Megjithatë, vlerësohet se numri i fëmijëve me nevoja të veçanta është më i lartë, mirëpo në shumë raste ata nuk raportohen nga familjet dhe nuk identifikohen nga institucionet. Nga ana tjetër ende nuk mund të flitet për integrimin e plotë të fëmijëve të kësaj kategorie në klasat e rregullta, pasi mungojnë mësimdhënësit ndihmës për të adresuar nevojat specifike të tyre, si dhe kushtet infrastrukturore përkatëse.

Zgjidhja

Kosova duhet **të shtojë pjesëmarrjen në edukimin në fëmijërinë e hershme, në veçanti për grup-moshën 4-6 vjet**. Kjo do të kishte efekte pozitive në zhvillimin intelektual, social dhe emocional të fëmijëve dhe në përgatitjen e tyre për shkollimin fillor. Ai që sot njihet si edukim parafillor (mosha 5-6 vjet) duhet të bëhet pjesë e shkollimit të obligueshëm dhe duhet krijuar mundësi që fëmijët e moshës 4-5 vjet të marrin pjesë në forma të ndryshme të edukimit parashkollor, duke i

⁴⁸ https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg_04_30/default/table?lang=en
Strategjia për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2017-2021.
<https://bit.ly/32Bt2Oa>

kushtuar kujdes fëmijëve nga grupet e marginalizuara të shoqërisë. Kjo mund të bëhet përmes hapjes së grupeve parashkollore për këta fëmijë në shkollat rurale dhe në objekte të tjera të përshtatshme ku do të ofrohej një program i shkurtuar për fëmijët e kësaj grup-moshe me qëndrim 2-3 orësh në shkollë.

Po ashtu **duhet të rritet përfshirja në arsimin e detyrueshëm dhe të mesëm të lartë e fëmijëve nga grupet shoqërore të marginalizuara, në veçanti atyre nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, si dhe i fëmijëve me aftësi të kufizuara.** Ky është parakushti themelor për integrimin e këtyre kategorive të bashkëqytetarëve tanë në shoqëri dhe shkëputja e tyre nga qarku i varfërisë dhe izolimit, brenda të cilit ndodhen shumë prej tyre. Krahas kësaj, duhet shtuar edhe cilësinë e shërbimeve arsimore dhe sociale që ofrohen për këto kategori në mënyrë që të zvogëlohet hendeku në arritje mësimore mes tyre dhe pjesës tjetër të popullsisë.

3.3.2. Cilësia e arsimit

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Ekziston një konsensus i përgjithshëm se cilësia e arsimit parauniversitar në Kosovë në dy dekadat e fundit është e ulët, megjithëse janë bërë shumë përpjekje nga strukturat politike që gjendja të paraqitet ndryshe. Prova më e mirë për mungesë cilësie është rezultati i testit ndërkombëtar PISA i dizajnuar për të matur aftësinë e 15-vjeçarëve për zbatimin e njohurive në praktikë. Ky test në vitin 2015 dhe 2018 e radhiti Kosovën në mesin e tri vendeve të fundit nga 70, përkatësisht 79 vende pjesëmarrëse. Në përgjithësi nxënësit kosovarë ngecin shumë pas mesatares së OECD. Sipas rezultateve të vitit 2018,⁴⁹ në fushën e leximit⁵⁰ kjo ngecje është 134 pikë, në matematikë – 123 pikë, ndërsa në shkenca të natyrës 124 pikë, ku 40 pikë⁵¹ janë të barasvlershme me një vit shkollimi (Figura 5). Pra, aftësia e nxënësit tonë të klasës së dhjetë për t'i zbatuar njohuritë në jetë është e barasvlershme me një nxënës të klasës së shtatë të vendeve anëtare të OECD-së. Ngecja në raport me Shqipërinë, Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë është 0.7-2 vite shkollimi (28-86 pikë), varësisht nga disiplina ku bëhet vlerësimi.

⁴⁹ OECD: PISA 2018 Results- What students know and can do.
<https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/5f07c754-en.pdf?expires=1600239103&id=id&acc-name=guest&checksum=F4CB2E8FC4FCB6528C04F366B7543001>

⁵⁰ PISA e përkufizon leximin si aftësi për të kuptuar dhe për të shfrytëzuar tekstet e shkruara, si dhe për të reflektuar dhe ndërvepruar me tekste të shkruara, me qëllim të arritjes së qëllimeve personale, të përfitimit të njohurive, të zhvillimit të potencialit individual, si dhe me qëllim të pjesëmarrjes në shoqëri. Ky përkufizim bazohet në llojllojshmërinë dhe kompleksitetin e proceseve që përfshihen në aktivitete ditore të leximit.

⁵¹ 40 pikët e PISA, është një normë e përcaktuar nga OECD.

Brengë e veçantë është përqindja enorme e nxënësve që nuk e kanë arritur nivelin minimal të aftësive për t'i shfrytëzuar njohuritë në jetë – në Lexim: 78.7 për qind (mesatarja e OECD-së: 22.6 për qind); në Matematikë: 77 për qind (OECD: 24.1 për qind); në Shkenca të natyrës: 76.5 për qind (OECD: 22 për qind).⁵² Mosaftësia për të kuptuar dhe interpretuar tekstin e shkruar është alarmuese, meqë aftësia e përdorimit të gjuhës është themel për arritje në çdo fushë të jetës. Në fakt asnjë vend i Ballkanit në 15 vjetët e testit PISA nuk ka pasur rezultat kaq të dobët. Për çudi, Kosova nuk ka asnjë nxënës me arritje të lartë (nivelet 5 dhe 6), për dallim nga vendet e OECD-së ku 8.7 për qind të nxënësve janë me arritje të lartë në lexim: 10.9 për qind në matematikë dhe 6.8 për qind në shkenca të natyrës.


Rezultate të ngjashme jep edhe raporti i Bankës Botërore për indeksin e kapitalit njerëzor, Figura 5, i cili vlerëson se një fëmijë i lindur në Kosovë pritët të përfundojë 13.2 vjet arsim deri në moshën 18 vjet, por kur merret parasysh cilësia e arsimit (në rastin konkret rezultati në PISA), kjo barasvlerësohet me 7.9 vjet të shkollimit efektiv. Kjo nënkupton se një 18-vjeçar në Kosovë ka mesatarisht njohuritë dhe shkathtësitë e një 13-vjeçari.

Edhe pse suksesi i nxënësve është kombinim i shumë faktorëve të ndërlidhur me shkollën, familjen dhe shoqërinë, megjithatë konsiderohet se kurikula, mësimdhënia dhe tekstet shkollore janë tre faktorë të rëndësishëm që përcaktojnë performancën e nxënësve.

Tradicionalisht, ndryshimet kurikulare në Kosovë janë zhvilluar pa përgatitje të duhura dhe me shpejtësi, e cila në vend të ndryshimeve pozitive ka sjellë çrregullime në sistemin e arsimit. Një shembull ilustrativ janë ndryshimet e plan-programeve shkollore në periudhën 1977-1989 në kuadër të së ashtuquajturës reformë të arsimit të mesëm të orientuar, të cilat, duke synuar aftësimin e secilit nxënës për ushtrimin e një profesioni me përfundimin e shkollimit të mesëm, dëmtuan rëndë shkollën e mesme si urë lidhëse ndërmjet arsimit të detyrueshëm dhe atij universitar. Ndryshimet e plan-programeve në vitet e 90-ta të shekullit të kaluar dhe pasojat e tyre për nxënësit mund të justifikohen me rrethanat e jashtëzakonshme që nuk mundësuan një proces normal të reformës kurikulare. Për fat të keq kjo prirje vazhdoi edhe në periudhën e pasluftës, kur fillimisht në vitin 2001, pastaj në vitin 2011 u iniciuan ndryshime thelbësore në kurikulën e arsimit parauniversitar të cilat nuk rezultuan me efekte pozitive në klasë.

⁵² OECD: PISA 2018 Results - What students know and can do. <https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/5f07c754en.pdf?expires=1600239103&id=id&accname=guest&checksum=F4CB2E8FC4FCB6528C04F366B7543001>

Figura 5. Rezultatet e testit PISA 2018



Korniza kurikulare e vitit 2001, e para e këtij lloji në Kosovë, e cila nuk u aprovua asnjëherë zyrtarisht, u pasua me plan-programe lëndore të zhvilluara shpejt e shpejt, të cilat pa përgatitje të duhura filluan të zbatohen në shkollat e Kosovës. Me gjithë elementet pozitive që sollën plan-programet e reja, mungoi mbështetja për zbatimin e duhur të tyre në nivel të shkollës si pasojë e “çmontimit” të mekanizmave këshillues siç ishin entet pedagogjike, të cilat u zhbënë me vendim të UNMIK-ut në vitin 2000.

Në vitin 2008 u lansua një nismë e re e ndryshimit të kurikulës, duke e zëvendësuar atë me kurikulën e bazuar në kompetenca e që duhej të shënonte një shmangie nga qasja tradicionale e orientuar në transmetim të njohurive. Ideja ishte që korniza kurikulare të përcaktonte kompetencat që duhet t’i fitojnë nxënësit me përfundimin e arsimit parauniversitar, kurikulat bërthamë të përcaktonin strukturën e përgjithshme të lëndëve sipas fushave kurikulare, ndërkaq përmbajtjet programore të zhvillohen nga shkollat. Edhe pse pilotimi filloi në vitin 2011 në 92 shkolla, këtij procesi i mungoi organizimi, planifikimi, koordinimi, monitorimi dhe vlerësimi i mirëfilltë. Nga ky proces që vazhdoi për 6 vjet nuk u nxor asnjë publikim i vetëm për sfidat dhe mësimet e nxjerra nga pilotimi që do të mund të aplikoheshin me rastin e zbatimit të kurikulës në shkollat e tjera, përveç se u kuptua se shkollat e Kosovës nuk janë të përgatitura të zhvillojnë vetë përmbajtjen programore. Kjo bëri që MASH t’i kthehet praktikës së zhvillimit të plan-programeve mësimore në nivelin qendror, duke e vënë në pyetje vetarsyeshmërinë e nismës për ndryshime

kurikulare, pasi tanimë edhe kjo kurikulë ishte e orientuar në përmbajtje e jo në kompetenca.

Përkundër paqartësive dhe mungesës së përgatitjeve të duhura, në gushtin e vitit 2017, një muaj para fillimit të vitit të ri shkollor, është marrë vendimi që kurikula e re të shtrihet gradualisht në të gjitha shkollat e Kosovës. Përvoja e deritanishme ka identifikuar një numër sfidash, e ndër më të mëdhatë janë vështirësitë e mësimdhënësve për të ndryshuar qasjen e realizimit të aktiviteteve me nxënës dhe qasjen e format e vlerësimit të nxënësve. Qasja e bazuar në kompetenca është një filozofi e punës për të cilën mësimdhënësit nuk janë përgatitur fillimisht, ndërsa mbështetja që u është ofruar mësimdhënësve si parapërgatitje për zbatimin e kësaj reforme është jo e mjaftueshme duke pasur parasysh ndryshimin e madh që kjo reformë synon krahas gjendjes ekzistuese.

Faktori tjetër me ndikim të madh në suksesin e nxënësve është cilësia e mësimdhënies e cila ende nuk është adresuar në gjithë kompleksitetin e saj. Më shumë se përcjellje e një plan-programi, apo arritje e rezultateve të paracaktuara, zhvillimi i mësimdhënësve në Kosovë ende nuk është prezantuar si nevojë që mësimdhënësi të jetë krijues i kurikulës, krijues i materialeve mësimore dhe të jetë në gjendje të planifikojë dhe realizojë mësimdhënie të diferencuar dhe mësimdhënie që krijon nxënës kërkuar të informatës, pra mendimtarë kritikë dhe kreativë.

Sistemi i përgatitjes së mësimdhënësve përbëhet nga formimi fillestar i mësimdhënësve që realizohet nga institucionet akademike dhe zhvillimi profesional i tyre që realizohet nga vetë shkollat, si dhe një numër i konsiderueshëm i ofertuesve publikë dhe privatë. Edhe pse shteti ka vendosur politika dhe standarde për të dy nivelet e përgatitjes së mësimdhënësve, zbatimi i tyre në praktikë është i mangët dhe i pakoordinuar. Kështu, fakulteteve të edukimit u është besuar formimi fillestar i mësimdhënësve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, ndërsa në disa disiplina, siç janë gjuhët e huaja, artet dhe sportet këtë e bëjnë njësitë e veçanta akademike në kuadër të universiteteve publike. Përkundër monopolit që gëzojnë këto njësi akademike shteti si punëdhënës kryesor i mësimdhënësve të ardhshëm nuk ka ndërtuar mekanizma që sigurojnë se struktura kualifikuese dhe përgatitja e mësimdhënësve janë në harmoni me nevojat e kohës. Në fakt, gjatë 20 viteve të kaluara ka pasur shumë improvizime në përgatitjen fillestare të mësimdhënësve, sidomos në fakultetet e edukimit që janë krijuar nga ish-shkollat e larta pedagogjike, e ku kuadri mësimor shpesh është pranuar pa respektimin e kritereve të duhura akademike. Një shembull improvizimi ka qenë Programi për avancimin e kualifikimit të mësimdhënësve i financuar nga Buxheti i Kosovës dhe i menaxhuar nga Universiteti i Prishtinës, i cili ka bërë të mundur që të gjithë mësimdhënësit me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike që kanë pasur mundësinë të marrin pjesë në atë program të fitojnë diploma universitare. Po ashtu

improvizime ka pasur edhe në zhvillimin profesional të mësimeve për të cilin nuk ekziston asnjë mbikëqyrje apo koordinim nga ana e institucioneve shtetërore. Zhvillimi profesional i mësimeve, ashtu si ofrohet tani, nuk është përmbytësor dhe është më shumë i natyrës së intervenimeve të izoluar *ad hoc* që qëndrojnë në sipërfaqe për shkak se sistemi drejtohet nga oferta e jo nga kërkesa dhe shkola si njësi nuk ka rol në vendimmarrjen për zhvillimin profesional të mësimeve.

Me gjithë përpjekjet për të instaluar një sistem të vlerësimit të performancës së mësimeve, në Kosovë vazhdon të ketë paga të njëjta për të gjithë mësuesit pavarësisht nivelit të tyre të profesionalizimit, punës, përkushtimit e rezultateve me nxënës. Përveç mosdiferencimit me paga, nuk ka as fond e as mekanizma të veçantë për identifikimin dhe shpërblimin e atyre mësimeve që dëshmojnë me profesionalizëm të lartë, me punë e përkushtim të madh dhe me rezultate shumë të mira me nxënës. Për fat të keq kësaj shtate i ka kontribuar edhe vetë Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK) me kërkesat e vazhdueshme për rritje lineare të pagave, të cilat kryesisht janë përmbushur në kohë të fushatave zgjedhore me qëllim të sigurimit të votave, duke mos lënë kështu hapësirë që shpërblimi të bëhet sipas meritës.

Aktualisht tekstet shkollorë konsiderohen si një nga sfidat kryesore me të cilat përballlet sistemi i arsimit. Sigurimi i teksteve shkollorë falas për të gjithë nxënësit e arsimit të obligueshëm me një kosto të ulët, të përcaktuar nga shteti, ka bërë që botuesit e teksteve shkollorë të mos kenë asnjë motiv për t'i përmirësuar produktet e tyre dhe për t'i përshtatur ato me nevojat e kurikulës së re. Në këtë kuptim nuk investohet në procesin e hartimit të teksteve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me standardet e cilësisë. Edhe pse MASH ka përzgjedhur tekste të reja në dy vitet e fundit, ato kanë probleme e të meta të shumta të natyrave të ndryshme. Pikë së pari tekstet shkollorë në përgjithësi nuk janë të konceptuara në përputhje me frymën dhe filozofinë e kurikulës (së re), e cila tashmë është duke u zbatuar në Kosovë. Ato kanë shpërputhje me kurikulën në disa aspekte, si në qasje, në qëllime, në formë e në përmbajtje. Ndërsa në rrafshin praktik është dëshmuar se shumë tekste shkollorë kanë pasaktësi shkencore, përmbajtësore e interpretuese; kanë kontradikta e anomali logjike; gjuhën e kanë në shpërputhje me grup-moshën; janë të mbingarkuara në shumë aspekte (fakte të shumta, koncepte të vështira, tepër voluminoze, në shpërputhje me fondin e orëve ose moshën e nxënësve, etj.); janë të vjetruara si mendësi dhe për pasojë nuk i kontribuojnë zhvillimit të mendimit kritik të nxënësve dhe nuk stimulojnë e ndihmojnë përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies e të vlerësimit; kanë gjuhë e përmbajtje të papërshtatshme (stereotipizuese, paragjyquese, diskriminuese, ofenduese, etj.); kanë të meta e probleme me aspektet didaktiko-metodike. Kohët e fundit janë ngritur dyshime serioze në besueshmërinë e procesit

të përzgjedhjes së teksteve shkollore, me ç'rast janë favorizuar interesat biznesore të grupeve dhe individëve, gjë që ka ndikuar edhe në cilësinë e teksteve të botuara.

Zgjidhja

Kurikula mësimore **duhet të vendosë standarde të larta të arritjes dhe të sigurojë zhvillimin e kompetencave kyçe tek nxënësit në përputhje me kërkesat e shekullit XXI.** Duke marrë parasysh dinamikën e zhvillimit në kohën e sotme, shkolla duhet t'i aftësojë fëmijët për të nxënë gjatë gjithë jetës, duke zhvilluar tek ata kompetencat e nevojshme si: kompetenca e lexim-shkrimit, kompetenca e komunikimit në gjuhën amtare dhe të paktën dy gjuhë të huaja, kompetenca në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë (STEM), kompetenca digjitale, kompetenca qytetare, kompetenca e ndërmarrësisë, etj. **Reforma kurikulare duhet të jetë e planifikuar më mirë dhe duhet të sigurohen burimet e nevojshme për zbatimin e saj.**

Shteti duhet të sigurojë tekste shkollore cilësore, duke garantuar një proces të besueshëm të përzgjedhjes të bazuar në konkurrencë të shëndoshë dhe kriteret e procedura transparente të vlerësimit. Në raste të caktuara duhet inkurajuar edhe përkthimin dhe përshtatjen e teksteve shkollore nga gjuhë të huaja, në veçanti në fushën e matematikës dhe shkencave të natyrës. Po ashtu duhet të vlerësohen tekstet shkollore që janë në përdorim, duke mos hezituar të hiqen nga përdorimi ato që nuk i plotësojnë standardet e cilësisë.

Cilësia e mësimdhënies është përcaktuesi kryesor për suksesin e nxënësit në shkollë, prandaj nuk duhet kursyer angazhimin për përmirësimin e vazhdueshëm të programeve universitare për përgatitjen e mësimdhënësve. Kjo mund të arrihet vetëm duke marrë të gjitha masat e nevojshme që ato programe të jenë në përputhje me standardet më të larta të cilësisë përmes një procesi të besueshëm dhe rigoroz të akreditimit. Përveç kësaj, duhet **të ndërtohet një sistem efektiv që nxitë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe performancën e mirë si rrugë të vetme për avancim në karrierë të mësimdhënësve dhe përfitimet që sjell një avancim i tillë.** Oferta e programeve për zhvillim profesional duhet të jetë e drejtuar nga mësimdhënësit dhe relevante për specifikat e reformës shkollore. Në vend të vazhdimit të praktikës së rritjes lineare të pagave me qëllim të sigurimit të votave në kohë të zgjedhjeve duhet të ndërtohet një sistem i mirëfilltë i karrierës për mësimdhënësit, që mundëson shpërblimin në bazë të performancës.

3.3.3. Mbikëqyrja, inspektimi dhe vlerësimi i jashtëm

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Meqë sistemi arsimor në Kosovë është i decentralizuar, të gjitha institucionet arsimore publike të nivelit parauniversitar në vend, me përjashtim të 7-8 syresh

janë nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të komunave të cilat këtë rol e ushtrojnë përmes drejtorive komunale të arsimit. Ndërkaq inspektimi është kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Në Kosovë ekzistojnë dy lloje të inspektimit: inspektimi juridik-administrativ dhe inspektimi pedagogjik. Forma më e zakonshme e inspektimit pedagogjik është vlerësimi i jashtëm i shkollës, i cili realizohet periodikisht, duke ndjekur një metodologji të përcaktuar. Inspektorati i Arsimit është departament i veçantë i MASH-it dhe ka shtatë zyre rajonale me më shumë se 50 inspektorë të profileve të ndryshme.

Kapacitetet e drejtorive komunale të arsimit për të mbikëqyrë institucionet edukative-arsimore në varësi të komunave janë më se të kufizuara, sidomos në komunat e vogla. Pagat e stafit të DKA-ve janë më të vogla se pagat e stafit mësimor në shkolla dhe kjo i bën këto pozita joatraktive. Nga ana tjetër, vetë DKA-të nuk kanë ndonjë strukturë organizative e cila mbulon funksionet e ndryshme të shkollës. Kështu, në DKA nuk ka specialistë për infrastrukturë, kurikulë, zhvillim profesional të mësimdhënësve ose specialistë të fushave lëndore. Për shkak se shkollat nuk kanë pothuajse kurrfarë autonomie financiare, zyrtarët e arsimit në komunë rëndom duhet të merren me përmbushjen e nevojave të përditshme të institucioneve arsimore, duke filluar nga riparimet e vogla e deri tek investimet më të mëdha.

Deri në hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për inspektoratin e arsimit ky trup është përqendruar rëndom në inspektimin juridik-administrativ dhe është shfrytëzuar nga Ministria për komunikim me autoritetet lokale dhe institucionet edukative-arsimore në varësi të tyre. Edhe me këtë rol të kufizuar Inspektorati nuk ka qenë gjithnjë efektiv në ushtrimin e funksioneve të veta. Një shembull ilustrativ janë dhjetëra kopshte të palicencuara që vazhdojnë të punojnë në të gjitha qytetet e Kosovës, përkundër faktit se kjo bie ndesh me Ligjin. Kapaciteti i Inspektoratit të Arsimit për të ushtruar inspektimin pedagogjik është më se i kufizuar, pasi ky trup nuk ka specialistë të profilizuar të fushave mësimore dhe të niveleve të ndryshme të arsimit. Kjo vlen edhe për vlerësimin e jashtëm të shkollës i cili zhvillohet sipas një metodologjie komplekse dhe kërkon njohje të thellë të fushave të cilësisë.

Zgjidhja

Drejtoritë komunale për arsim duhet të riorganizohen në atë mënyrë që të mund të ushtrojnë rolin e vet mbikëqyrës, duke punësuar staf të kualifikuar dhe të profilizuar. Do të ishte ndihmesë e madhe nëse Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bashkëpunim me Ministrinë e Pushteti Lokal dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës i përcaktojnë standardet për strukturën organizative të DKA-ve, si dhe angazhohen për paga dinjitoze për stafin e DKA-ve, në mënyrë që të tërheqin mësimdhënësit dhe administratorët më të mirë.

Inspektorati i Arsimit duhet të riorganizohet dhe aftësohet për ushtrimin e rolit të vet pedagogjik, në veçanti për vlerësimet e jashtme të shkollave. Duhet shqyrtuar edhe

mundësinë e angazhimit të ekspertëve të jashtëm – mësimdhënës dhe drejtorë të shkollave – në procesin e vlerësimit të jashtëm, duke i kontribuar kështu ngritjes së cilësisë së vlerësimit. Rezultatet e vlerësimit duhet të jenë në funksion të përmirësimit të shkollës dhe një mjet për sigurimin e transparencës dhe llogaridhënies.

3.3.4. Infrastruktura dhe rrjeti i shkollave

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Në fushën e infrastrukturës është punuar mjaft në dy dekadat e fundit, kryesisht duke ndërtuar objekte shkollore dhe duke bërë rinovimin e objekteve ekzistuese. Investimet e tilla kryesisht, janë bërë nga mjetet e Buxhetit të Kosovës, por edhe nga donatorët sidomos në vitet e para të pasluftës kur është investuar në rindërtimin e objekteve të dëmtuara nga lufta. Si rezultat i ndërtimeve, në vitin shkollor 2019/20 rrjeti publik parauniversitar në Kosovë përbëhet prej 1.094 institucioneve edukative-arsimore, prej të cilave: 44 institucione parashkollore, 927 shkolla fillore dhe të mesme të ulëta dhe 123 shkolla të mesme të larta.⁵³

Viteve të fundit Kosova është ballafaquar me ndryshime të mëdha demografike. Në kuadër të këtyre ndryshimeve ka pasur zvogëlim të numrit të popullsisë si rezultat i zvogëlimit të natalitetit dhe migrameve jashtë vendit, si dhe ka pasur zhvendosje të qytetarëve nga viset rurale në zona urbane. Si pasojë e këtyre zhvillimeve, në Kosovë ka pasur zvogëlim të numrit të përgjithshëm të nxënësve dhe zbrazje të shkollave në vise rurale, por mbingarkesë të tyre në zonat urbane.

Krahas trendit në rënie të numrit të nxënësve në baza të vazhdueshme, nevoja për ndërtim të objekteve të reja është zbutur sadopak në vitet e fundit, duke vendosur tani theksin në cilësinë e infrastrukturës dhe mirëmbajtjen e shkollave. Në qendrat e mëdha urbane ende vërehet gjendja me klasa të mbingarkuara, ndërsa në përgjithësi infrastruktura është mjaft e vjetruar në tërë territorin dhe në masë të madhe nuk zbatohen normat dhe standardet e objekteve shkollore.

Në periudhën 2008 - 2014 janë investuar mbi 94 mil. euro për ndërtimin e 110 shkollave të reja dhe rinovimin e 9 të tjerave, pa ndonjë analizë të trendeve demografikë dhe, si rezultat i një vendimmarrjeje të tillë, sot shumë nga këto shkolla në Kosovë qëndrojnë gjysmë të zbrazëta, përderisa ka shkolla që punojnë në 2 e madje edhe në 3 ndërrime.

Të gjitha këto ndryshime e pasoja nuk janë përcjell me një riorganizim të rrjetit të shkollave në Kosovë. Për rrjedhojë, shumë shkolla nëpër fshatra të ndryshme kanë mbetur me numër të vogël të nxënësve, ku punohet në klasë me shumë pak nxënës,

⁵³ Ministria e Arsimit dhe e Shkencës: Statistikat e arsimit në Kosovë 2019/20.
https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/statistikat-e-arsimit-2019-2020_1.pdf

apo edhe më keq, punohet me klasë të kombinuara (nxënës të klasave të ndryshme mësojnë së bashku). Si të tilla, këto shkolla nuk ofrojnë ambient të përshtatshëm për zhvillimin e duhur intelektual, akademik, social e emocional të këtyre nxënësve. Në anën tjetër, klasat e stërmbushura me nxënës në disa shkolla urbane gjithashtu nuk ofrojnë kushte e ambiente të përshtatshme për arsim cilësor.

Zgjidhja

Duhet riorganizuar rrjetin e institucioneve të arsimit parauniversitar në Kosovë, duke pasur parasysh trendët demografikë të dhjetë vjetëve të fundit dhe projeksionet demografike për periudhën e ardhshme, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të infrastrukturës rrugore dhe mundësive për qarkullim. Në kohën e sotme është e papranueshme që fëmijët të ndjekin mësimin në klasa të kombinuara dhe në klasa me numër më pak se minimal të nxënësve, nëse ekzistojnë mundësi për transport të sigurt deri në një shkollë të afërt ku ka kushte optimale për punë.

Ndërtimet e reja dhe rinovimet **duhet të planifikohen me kujdes dhe në harmoni me trendët demografikë.** Ndërkaq, **hapësirat shkollore që lirohen duhet vënë në dispozicion të komunitetit.** Për shembull, në shumë shkolla ato mund të shfrytëzohen për të akomoduar grupe parashkollore për fëmijët e moshës 4-5 vjet, duke e zgjeruar kështu përfshirjen në edukim në fëmijërinë e hershme, ndërsa aty ku ka mundësi mund të shfrytëzohen edhe për mësim tërëditor ose qëndrim të zgjatur në shkollë. Për ta realizuar këtë mund të shfrytëzohet kuadri ekzistues i cili ngel pa e plotësuar normën.

3.4. Arsimi i lartë


Arsimi i lartë është përcaktuesi kryesor i zhvillimit të një shoqërie dhe e drejtë e çdo qytetari. Historia e arsimit të lartë në Kosovë është e re dhe lidhet me historinë e Universitetit të Prishtinës të themeluar në vitin 1970 si i vetmi institucion i arsimit të lartë (IAL) deri në vitin 2003, kur fillon liberalizimi i tregut të arsimit të lartë në Kosovë. Për shkak të rëndësisë strategjike në nivel kombëtar dhe me gjerë, pritjet për arsimin e lartë në ekonominë e bazuar në dije janë rritur dhe kanë ndryshuar. Aktualisht, një nga pritjet kryesore nga IAL-të është që të bashkëpunojnë ngushtë me palët e tjera, me synimin që t'i pajisin studentët me njohuri dhe shkathtësi në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Gjatë viteve të pasluftës në arsimin e lartë në Kosovë është vërejtur:

- (i) rritja e pjesëmarrjes në arsimin e lartë (aktualisht Kosova qëndron e renditur lart në listën e vendeve europiane me raportin bruto të regjistrimit me 66.1 për qind,⁵⁴ siç shihet nga Figura 6),

⁵⁴ UNESCO Institute for Statistics (UIS). <http://data.uis.unesco.org/>

- (ii) përmirësimi i kornizës ligjore – është aprovuar Ligji për arsimin e lartë dhe aktet e tjera nënligjore dhe
- (iii) përforcimi i planifikimit dhe monitorimit (janë hartuar dhe miratuar plane strategjike në nivel shtetëror dhe institucional) etj.

Figura 6. Raporti bruto i regjistrimit në arsimin e lartë⁵⁵



3.4.1. Institucionet dhe programet e arsimit të lartë

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Aktualisht në Kosovë ekzistojnë 32 institucione të arsimit të lartë, përkatësisht 7 universitete publike, 2 institucione publike të arsimit të lartë të specializuara dhe 23 institucione private të arsimit të lartë (pa i llogaritur 8 syresh që nuk janë akredituar gjatë vitit 2020).⁵⁶ Numri i programeve dhe institucioneve ka pësuar rënie në vitet e kaluara pasi që Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), përkundër ndërhyrjeve të vazhdueshme politike, gradualisht ka theksuar kriteret gjatë procesit

⁵⁵ Po aty.

⁵⁶ <http://www.akreditimi-ks.org/new/index.php/sq/homepage-2/98-kaa-articles-2/lajmet/434-njoftim-lidhur-me-vendimet-e-keshillit-shteteror-te-cilesise-kshc-ne-mbledhjen-e-mbajtur-me-25-06-2020>

të akreditimit, edhe pse ky proces vazhdon të jetë i kufizuar në verifikimin e përmbushjes së kërkesave minimale.

Nevojës për rritje të përfshirjes në arsimin e lartë dhe për ofrim të më shumë programeve të studimit, autoritetet kosovare i janë përgjigjur me themelim të institucioneve të reja publike të arsimit të lartë. Edhe pse i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, themelimi i tyre është bërë në kundërshtim me Ligjin, i cili kërkon që universiteti në momentin e themelimit të ketë ofruar të paktën 5 programe të doktoratës për 5 vjet dhe të ketë nxjerrë të diplomuar nga këto programe, ndërkohë që asnjëri prej institucioneve të reja nuk kanë programe të tilla as sot. Mospërmbushja e kriterëve ligjore nuk ishte pengesë për akreditimin dhe riakreditimin e këtyre institucioneve. Opinioni publik e ka vlerësuar këtë rritje të institucioneve publike të arsimit të lartë si përmbushje të interesave të individëve dhe grupeve të caktuara politike. Në këto institucione u soll një pjesë e stafit të dirigjuar nga politika, duke shpërfillur të gjitha standardet e cilësisë.

Pothuajse të gjitha institucionet private të arsimit të lartë janë organizata fitimprurëse dhe mbajnë një qasje utilitare, duke ofruar programe që kërkohen nga studentët, pavarësisht ngjashmërisë së tyre me programet e institucioneve të tjera. Kjo ndodh edhe tek institucionet e reja publike të arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe të ngjashme me njëri-tjetrin ose sipas modelit të programeve të Universitetit të Prishtinës. Sa për ilustrim, pesë nga shtatë universitetet publike ofrojnë programe në shkencat juridike dhe ekonomike, ndërsa programe të ngjashme ofrohen edhe në shumicën e kolegjeve private edhe pse në këto fusha tanimë kemi mbi 6.000 të diplomuar të papunë.⁵⁷ Fatkeqësisht, edhe procesi i rekrutimit të stafit akademik është stërkequr, duke mos përfillur kriteret shkencore dhe si për pasojë shumë nga profesorët në këto institucione të arsimit të lartë nuk i plotësojnë as kushtet minimale për pozitat që kanë zënë.

Është fakt se tregu i punës preferon më shumë të diplomuarit nga Universiteti i Prishtinës,⁵⁸ që nënkupton se ekziston një rezervë për të diplomuarit nga institucionet e tjera publike të sapothemeluara për shkak të cilësisë së ulët që demonstrojnë edhe në fusha shumë të kërkuara nga tregu i punës.

Zgjidhja

Duke pasur parasysh shumëfishimin mekanik dhe jocilësor të programeve të studimit nga Universiteti i Prishtinës, **institucionet rajonale të arsimit të lartë duhet të ristrukturohen, duke i reduktuar programet e shumëfishuara, me mundësi të shkrirjes në më pak institucione publike, por që cilat i plotësojnë kriteret e cilësisë.**

⁵⁷ From university to employment, Higher education provision and labour market needs in Kosovo, Bartlett, Will; Skikos, Helene; Gashi, Ardiana, 2016, <https://dx.doi.org/10.2766/081857>

⁵⁸ STIKK - Identifikimi i nevojave të tregut të punës në sektorin e TIK-ut https://stikk.org/wp-content/uploads/2018/11/Publications_2015_-_Skills_Gap_SQ.pdf

Po ashtu, ky proces i ristrukturimit do të shërbente dhe për filtrimin, verifikimin a kontrollimin e stafit akademik për plotësimin e kërkesave profesionale dhe shkencore. Statusi juridik dhe emërtimi i këtyre institucioneve duhet të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, që nënkupton rishikimin e emërtimeve aktuale.

Një **alternativë tjetër** është profilizimi - grupimi i IAL-ve publike të arsimit të lartë në disa fusha, gjithnjë duke insistuar në përmbushjen e kushteve ligjore për statusin juridik dhe emërtimin e institucioneve të reja të arsimit të lartë që do të dalin nga këto grupime. Grupimi i tillë do të nënkuptonte që Kosova të ketë 3-4 institucione publike të arsimit të lartë (universitete, kolegje universitare ose kolegje) në të cilat do të integroheshin edhe 6 universitetet e tanishme rajonale.

Ndërkaq, sektorit privat nuk mund t'i kufizohet lloji i programeve që do të ofrojë, por duhet marrë të gjitha masat që të sigurohet cilësia e ofertës, duke zbatuar standarde të larta të akreditimit si në raport me përmbajtjen programore, ashtu edhe me personelin akademik përgjegjës për realizimin e saj.

3.4.2. Sa janë cilësore diplomat tona

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Cilësia paraqet hallkën me të dobët në zinxhirin e arsimit në Kosovë, gjë që dëshmohet së fundmi edhe me rezultatet e testit PISA të viteve 2015 dhe 2018 në arsimin parauniversitar, si dhe me renditje të dobët në rajon në arsimin e lartë (shih figura 7). Edhe pse Universiteti i Prishtinës, sipas Webometrics⁵⁹ në vitin 2020 është IAL me rangimin më të mirë të IAL-ve shqipfolës në rajon, duke u renditur në pozitën 2772, në renditjen botërore megjithatë situata ndryshon shumë kur të krahasohemi me institucionet simotra të arsimit të lartë të vendeve të rajonit, siç është paraqitur tek figura 7. Përveç Universitetit të Tiranës, që është mbrapa për 1881 vende, të gjitha universitetet publike të vendeve fqinje, si Shkupi, Nishi e Sarajeva janë dukshëm më mirë të renditura, mbi 1000 vende, krahasuar me Universitetin e Prishtinës.


Në përgjithësi arsimin e lartë e kanë karakterizuar kapërcimi artificial nga sistemi tradicional në sistemin e Bolonjës, shumëzimi pa asnjë kontroll i cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë, fillimisht atyre private, ndërsa më vonë edhe i atyre publike, aplikimi mekanik i legjislacionit në fuqi dhe tendenca për improvizim të proceseve të cilësisë (si procesi i akreditimit).

Agjencia për Akreditim e Kosovës (AKA) në mungesë të kapaciteteve njerëzore nuk ka arritur të bëjë verifikimin e saktësisë së informacioneve dhe dëshmive të ofruara nga

⁵⁹ <http://www.webometrics.info/en/Europe>

IAL-të gjatë procesit të akreditimit, që është një nga faktorët për akreditimin jomeritor të shumë programeve dhe institucioneve krahas ndikimeve politike dhe të grupeve të caktuara të interesit. Përpos procesit të akreditimit i cili përcillet me sfida të shumta, në Kosovë nuk aplikohet sistemi i monitorimit si një proces i vazhdueshëm i sigurimit të cilësisë i cili kontrollon nëse institucioni vazhdon të mirëmbajë standardet e cilësisë me të cilat fillimisht është akredituar. Kështu, në Kosovë kemi një sistem arsimor të shkëlqyeshëm “me letra”, ndërsa gjendja faktike është para kolapsit dhe krejt kjo si pasojë e mungesës së monitorimit të tyre.

Figura 7. Krahassimi i institucioneve të arsimit të lartë në rajon



Burimi: Webometrics.info

Për më keq, Kosova është përjashtuar nga dy mekanizmat kryesorë të sigurimit të cilësisë në Europë: Rrjetit European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) dhe Regjistrin European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (EQAR), gjë që ka krijuar pasoja të pariparueshme për sistemin e arsimit të lartë. Përjashtimi nga EQAR dhe ENQA ka ndodhur kryekëput për shkak të ndërhyrjeve politike të Qeverisë dhe MASH-it në AKA, me çka është dëshmuar edhe një herë brishtësia e sistemit për sigurimin e cilësisë, por, në anën tjetër, është vënë në pah nevoja për krijimin e parakushteve ligjore për sigurimin e pavarësisë së institucioneve profesionale siç është AKA.

Programet e studimit nuk i referohen kërkesave të Kornizës kombëtare të kualifikimeve për shkathtësitë, kompetencat dhe aftësitë e studentëve dhe ka sfida sa i përket formave të vlerësimit të rezultateve të të nxënës nga mësimdhënësit. Përveç mangësive evidente në mësimdhënie, puna praktike është sipërfaqësore dhe pa ndonjë nxitje të mendimit kritik dhe kreativ. Numri i madh i studentëve brenda klasave dhe grupeve pamundëson një proces efektiv të mësimdhënies, nuk nxit aftësitë kritike dhe kreative dhe nuk rrit interaktivitetin me ta. Edhe në raportin e BE-së⁶⁰ për nevojat e tregut të punës nga viti 2016 theksohet ankesa e punëdhënësve ndaj të sapodiplomuarve lidhur me zbatimin praktik të dijes dhe shkathtësive të fituara gjatë arsimit të lartë.

Përkundër zhvillimit të madh të sigurimit të cilësisë në Europë, në Kosovë ende aplikohet procesi i akreditimit si përmbushje e kriterëve minimale të cilësisë të përcaktuara në legjislacionin vendor. Proces i akreditimit në Kosovë është proces i obligueshëm ligjor dhe IAL-të kanë pasoja juridike nëse nuk arrijnë të marrin akreditimin. Sistemi i sigurimit të cilësisë ende nuk është zhvilluar në masën e duhur që të mos synohet vetëm plotësimi i kriterëve minimale, por edhe tejkalimi i tyre dhe krijimi i kulturës së cilësisë ashtu siç ndodh në shtetet e zhvilluara të Evropës.

Fatkeqësisht, edhe pse Agjencia e Kosovës për Akreditim është më e vjetra në rajon, e themeluar në vitin 2004 dhe e funksionalizuar katër vjet më vonë, ajo ende mbetet me numrin më të vogël të stafit, siç është paraqitur në tabelën 2. Është iluzore të pritët që me staf kaq të vogël të kemi një sistem të konsoliduar të sigurimit të cilësisë, e mos të flasim për monitorimin e IAL dhe për përmirësimin e cilësisë.

Tabela 2. Ndërlidhja e stafit të Agjencisë me cilësinë në IAL

	Slovenia	Serbia	Kroacia	Bullgaria	Mali i Zi	Kosova
Institucione të Arsimit të Lartë (IAL)	50	26	50	50	8	30
Numri i stafit në Agjenci të Akreditimit	32	25	45	34	8	5
Raporti IAL/staf të Agjencisë	1.56	1.04	1.11	1.47	1.00	6.00
IAL me renditjen më të mirë sipas Webometrics	321	454	608	942	2042	2829

Në shumicën e rasteve procesi i vlerësimit të brendshëm të IAL-ve, i cili i paraprinë akreditimit, është mekanik dhe nuk merret si mundësi për diskutim për cilësinë, por thjesht si mbushje letrash dhe ushtrim burokratik. Ndërkaq vlerësimi i jashtëm krijon situata hierarkike komunikative dhe zyrtarisht quhet “intervistë”. Ky term dallon shumë nga diskutimi i cili është më pak hierarkik dhe më i frytshëm në

⁶⁰ From university to employment, Higher education provision and labour market needs in Kosovo, Bartlett, Will; Skikos, Helene; Gashi, Ardiana, 2016, <https://dx.doi.org/10.2766/081857>

krahasim me intervistën që e zhvillojnë ekspertët, ku komunikimi është njëdrejtimësh dhe ndërveprimi është minimal, duke e shndërruar këtë proces në ushtrim mekanik burokratik.

Zgjidhja

Agjencisë së Kosovës për Akreditim ende i mungojnë kapacitetet dhe mekanizmat e duhur për të monitoruar punën e institucioneve të arsimit të lartë. Me qëllim të plotësimit të kriterëve jo vetëm minimale dhe teknike, por edhe aplikimin e procesit të monitorimit dhe përmirësimit të cilësisë së programeve të studimit dhe institucioneve të arsimit të lartë AKA duhet të shtojë stafin e vet profesional dhe të kërkojë nga IAL-të **të zbatohen me përpikëri kriteret teknike, minimale, në lidhje me: (i) ngarkesën e mësimdhënësit, (ii) raportin student-profesor, (iii) hapësirën fizike për studentë, (iv) numrin maksimal të studentëve në një grupi-klase-gjenerate dhe (iv) parametrat kyç të përcaktimit të performancës së stafit dhe institucionit të arsimit të lartë.**

Sistemi i arsimit të lartë është dëmtuar rëndë pas ndërhyrjes flagrante të politikës në pavarësinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim. Largimi nga këto dy rrjete e ka lënë AKA-në pa mbikëqyrje ndërkombëtare dhe i ka hapur rrugën politikës për ndërhyrje akoma më flagrante në punët e saj gjatë periudhës vijuese. Prandaj AKA dhe MASH **duhet të zhvillojnë një strategji afatshkurtër për rikthimin e AKA-së në ENQA dhe EQAR**, duke i siguruar te gjitha kushtet për mirëfunksionimin e Agjencisë sipas standardeve ndërkombëtare.

3.4.3. Integriteti dhe transparenca

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Edhe pse IAL-të kanë rregulla ta shkruara dhe strikte për procedurat e përzgjedhjes së stafit akademik dhe administrativ, ato nuk zbatohen gjithmonë me transparencë të plotë, prandaj universiteti është shndërruar në një mundësi punësimi e jo në një synim intelektual. Në radhë të parë dominojnë kriteret sasiore dhe jo cilësore të përzgjedhjes së stafit, gjë që mundëson ndërhyrjen e grupeve të interesit dhe politikës. Rekrutimi politik i stafit administrativ dhe menaxherial është sulm i drejtpërdrejtë në cilësinë e arsimit, sepse mundëson që profesorit t'i shkelet dinjiteti dhe integriteti përmes një sistemi të korrumpuar burokratik, i cili fillon prej investimeve në infrastrukturë dhe materiale shpenzuese e deri te avancimi akademik.

Shumica e institucioneve të arsimit të lartë formalisht kanë krijuar procedurat dhe mekanizmat për zbatimin e parimeve të etikës në procesin e administrimit, mësimdhënies dhe hulumtimit shkencor. Megjithatë, komisionet e etikës janë formalisht funksionale dhe aplikimi i procedurave të kodeve të etikës nuk bëhet në mënyrë transparente dhe publike.

Po ashtu mungon transparencja në avancimin e mësimdhënësve sa i përket zbatimit të rregullores për vlerësimin e performancës së tyre, gjë që e mundëson promovimin akademik jashtë standardeve profesionale dhe e toleron punësimin e shumëfishtë dhe angazhimin e profesorëve në poste brenda dhe jashtë institucioneve të arsimit të lartë. Transparencja mungon edhe në vlerësimin e hulumtimeve në rastet kur profesorët botojnë shpejt duke kopjuar e kompiluar shpeshherë edhe hulumtime e rezultate të huaja.

Duke i dhënë më tepër përparësi hulumtimit kundruall mësimdhënies, roli i kësaj të fundit shihet si sekondar. Mësimdhënia perceptohet nga profesorët si e parëndësishme për shkak të këtij mosvlerësimi nga menaxhmenti dhe vetë studentët rrjedhimisht e krijojnë këtë bindje.

Zgjidhja

Gjatë procesit të zgjedhjeve të stafit akademik duhet **të identifikohen dhe të filtrohen profesorët jokompetentë** të cilët janë pjesë e arsimit të lartë dhe të cilët e riprodhojnë veten duke e sjellë edhe stafin e ri sipas standardit të vet. Ky filtrim duhet të përfshijë: procesin e **botimeve** të tyre, duke e pasur parasysh verifikimin e autorësisë dhe të fushës përkatëse shkencore që duhet të përkojë me ekspertizën e autorit, **mësimdhënien**, duke e pasur parasysh cilësinë e performancës të verifikuar edhe me vlerësimin e studentëve për mësimdhënësin, **rekrutimin e asistentëve**, duke e pasur parasysh favorizimin e kandidatëve jomeritorë dhe mospërfilljen e standardeve akademike gjatë angazhimit të tyre.

Po ashtu duhet **të identifikohen dhe të filtrohen zyrtarët administrativë joprofesionalë** të cilët janë pjesë e arsimit të lartë dhe të cilët mundësojnë realizimin e synimeve të grupeve të caktuara të interesit.

Të funksionalizohen mekanizmat ekzistues për zbatimin e kodeve të etikës nëpër IAL me qëllim të rritjes së transparencës dhe sigurimit të besueshmërisë.

Të vendosen kritere të qarta e të matshme të performancës akademike, ku përfshihet edhe saktësimi i numrit të vendeve të punës. Në veçanti **duhet të kërkohet nga profesorët të cilët angazhohen me poste politike dhe ekzekutive që ta pezullojnë marrëdhënien e punës me IAL**, ashtu si ndodh në rajon dhe në botë.

3.4.4. Organizimi studentor në funksion të klaneve

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Sipas standardeve evropiane të sigurimit të cilësisë, institucionet e arsimit të lartë duhet të inkurajojnë studentët të marrin rol aktiv në krijimin e procesit mësimor dhe gjithashtu vlerësimi i studentëve të reflektojë këtë qasje. Fatkeqësisht, në institucionet arsimore në Kosovë roli i përfaqësuesve të studentëve rrallë ka për

qëllim përfshirjen e tyre në proceset e vetëvlerësimit dhe sigurimit të cilësisë, ashtu siç e parasheh Zona Evropiane e Arsimit të Lartë. Organizatat studentore, sidomos në IAL-të publike nuk merren në radhë të parë me çështje që u përkasin drejtpërsëdrejti studentëve, por përfaqësojnë një larmi interesash të ndryshme. Për më shumë, përfaqësuesit e studentëve kanë krijuar varësi nga grupe të caktuara të interesit, duke i përfshirë edhe partitë politike të Kosovës, gjë që reflektohet në faktin se shpesh organizatat studentore nuk reagojnë kur dëmtohet cilësia në arsimin e lartë.

Rrjedhimisht, këto organizata janë vënë në funksion të klaneve të cilat pas kryerjes të studimeve i shpërblejnë me avancim në karrierë dhe me poste nëpër institucione me rëndësi. Për fat të keq, kjo praktikë tanimë është pranuar si e zakonshme dhe as që shihen përpjekje për të bërë ndryshime. Madje është bërë e zakonshme që të shkelet statuti në IAL-të publike, ku përfaqësuesit e studentëve gjithmonë i sigurojnë afatet e parregullta të provimeve dhe mundësinë për të hyrë pa asnjë kufizim nëpër provime. Kjo shkelje e statutit i ngarkon profesorët, e pengon procesin mësimor dhe e shndërron vlerësimin në formalitet. Funksionimi i përfaqësuesve të studentëve si dorë e zgjatur e klaneve të caktuara i ka faktorizuar ata deri në atë masë sa të kenë rol vendimtar në secilën hallkë të jetës akademike, duke filluar që nga regjistrimi i studentëve, angazhimi dhe avancimi i mësimdhënësve, përzgjedhja e menaxhmentit e të tjera.

Arsimi i lartë në Kosovë aktualisht ka synim të prodhojë numra me të cilët mund të bëjnë fushata politikanët dhe nuk ka synim të krijojë intelektualë nga të cilët përfiton shoqëria. Harrohet se universitetet nuk i përgatisin studentët vetëm për treg, por e zhvillojnë dhe e përkufizojnë identitetin e tyre dhe të shoqërisë. Për shkak të numrit të madh të studentëve, ky rol shoqëror i universitetit po bëhet gjithmonë e më i parëndësishëm dhe e humb funksionin. Arsimi i lartë duhet të formojë qytetarë me mendim kritik, të cilët janë në gjendje ta përdorin dijen e tyre për mirëqenien e vet dhe të shoqërisë. Për fat të keq mungesa e mendimit kritik bie në sy te përfaqësuesit e studentëve dhe te procesi i përzgjedhjes së tyre, që dëshmon për mungesën e një konkurrence në bazë të aftësive e dijes dhe dominimin interesave klanore e partiake.

Vënia në funksion të interesave klanore ndërlihet edhe me mendësinë e shoqërisë dhe shkollës sonë ku dominon kontrolli autoritar dhe hierarkia dhe të rinjtë të cilët e përvetësojnë këtë model arrijnë sukses, ndërsa mendjehapurit (mendjendriturit) dhe dinjitozët zakonisht dekurajohen. Modeli kulturor i arsimit të lartë në Kosovë është autoritar dhe servil: ata studentë të cilët përparojnë janë të dëgjueshmit, ata që e pranojnë në mënyrë të padiskutueshme hierarkinë e sjellë nga politika dhe që bashkëpunojnë me të. Këta bëhen trashëgimtarë të profesorëve jokompetentë që krijojnë vizion të pashpresë për brezat e ardhshëm.

Shumica e studentëve tanë kanë pak mundësi për ta tejkaluar mendësinë e mjedisit të vet dhe për të hyrë në konkurrencë jashtë vendit. Programet ekzistuese evropiane për studime jashtë nuk shfrytëzohen mjaftueshëm për shkak të mosnjohjes së gjuhëve të

huaja si dhe për mungesën e interesimit. Për më shumë, studentët nuk kanë mundësi as për shkëmbim përvojash me universitetet shqiptare në vendet shqipfolëse, që do t'u jepte mundësi t'i krahasojnë përvojat e ndryshme akademike e të hyjnë në konkurrencë përtej mjedisit të vet. Në vitet e fundit është themeluar dhe funksionalizuar Unioni Studentor i Kosovës, që është organizatë ombrellë e gjithë studentëve të institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë - publike dhe private. Unioni Studentor i Kosovës deri tani nuk ka ndërmarrë ndonjë rol aktiv për përfaqësimin e gjithë studentëve në nivelin politikëbërës. Fatkeqësisht, në mungesë të organizimit të mirëfilltë studentor si dhe për shkak të lobit të fortë të studentëve nga Serbia, Unioni Studentor i Kosovës nuk ia ka dalë të anëtarësohet në Unionin Evropian të Studentëve.

Zgjidhja

Roli i studentëve duhet të depolitizohet dhe të sigurohet pjesëmarrja e tyre në çështjet që u përkasin atyre. Urgjentisht duhet të ndërpriten shkeljet statutare, si afatet e paligjshme të provimeve dhe hyrja e pakufizuar nëpër provime në funksion të Deklaratës së Bolonjës të cilën IAL-të kosovare pretendojnë se e kanë përvetësuar plotësisht. **Përfaqësuesit e studentëve duhet të zgjidhen duke respektuar kriteret maksimale profesionale dhe etike të siguruara përmes treguesve të matshëm.**

Të rinjtë tanë duhet të konkurrojnë globalisht përmes ndërkombëtarizimit të vlerave dhe kulturës sonë të mirëfilltë kombëtare. Fillimisht duhen gjetur mekanizmat institucionalë për shkëmbimin e mësimdhënësve dhe studentëve brenda rajonit, në radhë të parë me universitetet shqipfolëse, duke mundësuar jo vetëm shkëmbimin e dijes dhe përvojave, por edhe zhvillimin individual dhe mundësinë për të krahasuar njohuritë e përvetësuar duke u përballur me rrethana të reja akademike dhe shoqërore dhe duke u përgatitur drejt bashkëpunimit ndërkombëtar.

3.4.5. Kërkimi shkencor

Problematika dhe gjendja ekzistuese

Për të siguruar zhvillim të përgjithshëm të një vendi, puna hulumtuese dhe zhvillimore duhet të jetë gjithëpërfshirëse në aspektin e ekonomisë, shkencave mjekësore, shkencave të natyrës, shkencave teknike, atyre shoqërore dhe artit. Institucionet hulumtuese në Kosovë duhet të sigurohen se ekziston një bashkëpunimin tërëdisiplinar nga fushat e ndryshme në mënyrë që njohuritë dhe hulumtimi shkencor të zhvillohen në të mirën e shoqërisë. Kjo do të racionalizonte efektivitetin e punës hulumtuese-zhvillimore, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm që inkorporon idetë dhe ekspertizat nga profilet e ndryshme në përputhje me planifikimet strategjike zhvillimore brenda vendit dhe trendët globalë.

Meqë hulumtimi cilësor është parakusht për çdo zhvillim të qëndrueshëm, ai duhet të përputhet me standardet ndërkombëtare për të mundësuar ruajtje dhe zhvillim

të shëndoshë të resurseve shoqërore që do të siguronin kushte për t'u përballur me sfidat e zhvillimit të vendit dhe më gjerë.

Bartësit kryesor të hulumtimit dhe zhvillimi shkencor-artistik janë Akademia e Shkencës dhe e Arteve e Kosovës, institucionet e arsimit të lartë dhe institutet hulumtuese. Edhe pse pothuajse të gjitha këto institucione nëpër dokumentet e tyre strategjike paraqesin vizion kryesisht të përbashkët në lidhje me kërkesat për politika adekuate hulumtuese dhe zhvillimore, reformat dhe sfidat e tyre për sa i përket qasjes së hulumtimit shkencor-artistik janë të fragmentuara, me mungesë të dukshme të një qasjeje të integruar.

Nga 32 IAL të licencuara në Kosovë, vetëm Universiteti i Prishtinës është indeksuar nga SCIMAGO Institutions Rankings,⁶¹ ndërsa institucionet e tjera (publike dhe private) janë të papërfillshme, sepse ato nuk kanë publikime të indeksuara nga SCOPUS, pra institucionet e tjera konsiderohen se nuk merren fare me shkencë.


Për më shumë, figura 8 tregon që IAL-të në Kosovë janë institucione të orientuara kah mësimdhënia dhe shumë pak kah hulumtimi, duke pamundësuar kështu përmbushjen e misionit të një universiteti, ku mësimdhënia dhe hulumtimi shkojnë krah për krah me njëra-tjetrën.

Sot në botë përkrahja financiare e aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore mbështetet në tri shtylla kryesore: në buxhetin e shtetit, bashkëpunimin me palët e treta (ekonominë) dhe absorbimin e fondeve ndërkombëtare të dedikuara për hulumtim dhe zhvillim. Më qëllim të mbështetjes së veprimtarisë hulumtuese, Ligji për veprimtarinë kërkimore–shkencore përcakton deri në 0.7 për qind të buxhetit vjetor të shtetit për këtë veprimtari. Deri tani kjo shifër ka qene shumë herë më e ulët se sa përcaktimi ligjor (rreth 0.1 për qind).

Edhe përkundër vështirësive, sot ka nisma hulumtuese shkencore-artistike serioze, kryesisht përmes bashkëpunimit të suksesshëm që institucionet hulumtues vendore zhvillojnë me një numër të konsiderueshëm të institucioneve akademike dhe kërkimore nga vendet e tjera të botës dhe të rajonit. Këto aktivitete kanë ngritur kapacitetet humane dhe infrastrukturore në vend, duke iniciuar vendosjen e lidhjeve ndërmjet ekonomisë dhe institucioneve akademike, koordinimit më të mirë të palëve me interes nga ekonomia dhe shoqëria në hartimin e kurikulave për programet studimore. Në fushën hulumtuese-shkencore, kjo ka ndikuar edhe në rritjen e numrit të publikimeve shkencore të personelit hulumtues, madje rritjen e citimeve të publikimeve, rangimin e avancuar të disa institucioneve të arsimit të lartë në vend në platforma prestigjioze botërore, digjitalizimin e shërbimeve dhe sigurimin e të dhënave të sistemuara, etj.

⁶¹ <https://www.scimagoir.com/>

Figura 8. Renditja e universiteteve të rajonit sipas indeksimit në SCIMAGO



Popullata relativisht e re e Kosovës përbën një avantazh në aspektin e zhvillimit të resurseve njerëzore edhe në fushën e hulumtimeve, prandaj është e rëndësishme që institucionet kosovare të shfrytëzojnë këtë përparësi. Për të siguruar një gjë të tillë duhet eksploruar modele të ndryshme të aplikuara nga shtetet të cilat në mënyrë të suksesshme kanë reduktuar procesin 'braindrain'. Minimizimi i procesit 'braindrain' është ngushtë i ndërlidhur me krijimin e hapësirës për hulumtuesit e ri kosovarë, të cilat në pamundësi për të kontribuar në Kosovë mund të kërkojnë alternativa të tjera jashtë Kosovës.

Parakusht i rëndësishëm për të siguruar arritjen e rezultateve relevante në hulumtime shkencore mbetet zhvillimi i infrastrukturës adekuate që përfshin: ndërtesat, pajisjet laboratorike, bibliotekat dhe qasja në databaza shkencore.

Puna hulumtuese dhe zhvillimore duhet të ketë pikësynim sjelljen e inovacioneve dhe përfitimeve të përgjithshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtarë. Megjithatë ky aspekt kritik i punës kërkimore është i mangët, apo më mirë të themi është në fazat fillestare në Kosovë, është e rëndësishme që fillimisht të intensifikohen përpjekjet për zhvillimin e një kulture të përgjithshme të inovacionit në institucionet hulumtuese kosovare që kanë potencial të prodhojnë punë kërkimore dhe zhvillimore.

Studimet e doktoratës mbeten pika më e rëndësishme që mundësojnë identifikimin dhe trajnimin e resurseve njerëzore në hulumtime dhe zhvillim dhe lidhin arsimin, kërkimin shkencor dhe inovacionin. Bashkëpunimi i ngushtë dhe mobilitetet me

hulumtuesit e institucionet kërkimore ndërkombëtare mbeten kritike për avancimin e studimeve të doktoratës në Kosovë.

Në shkallë gati të papërfillshme është bashkëpunimi i komunitetit hulumtues me ekonominë dhe industrinë. Kjo mund të shpjegohet me faktin se, së pari për mungesë industrie, pastaj për mungesë besimi, por edhe për mungesë gatishmërie të stafit dhe institucioneve për t'u përballur me problemet e industrisë ndodh kështu.

Zgjidhja

Duke pasur parasysh politikat kombëtare për hulumtim dhe zhvillim të **sigurohet respektimi i kriterit të meritokracisë, si dhe monitorimi dhe vlerësimi i aktiviteteve hulumtuese dhe zhvillimore.**

Zhvillimi i kulturës së inovacionit në punën hulumtuese, përveç të tjerash, mund të bëhet përmes mbështetjes së zhvillimit të inkubatorëve përbrenda institucioneve, si mekanizma për të arritur rezultate zhvillimore.

Paradigma e izolimit nga problemet shoqërore mund të tejkalohet përmes funksionalizimit të institucioneve hulumtuese që të shtjellojnë projekte si përgjigje ndaj nevojave për qëndrueshmërinë humane, ekologjike dhe ekonomike, duke u nxitur ndërdisiplinariteti.

Hulumtuesit **duhet të nxiten që veprimtarinë dhe publikimet e tyre shkencore t'i bëjnë publike në revista kredibile botërore dhe vendore** dhe të inkurajohen t'i prezantojnë arritjet e tyre para komunitetit akademik.

Duhet bërë përpjekje që **programet doktorale të organizohen në gjuhën angleze, përveç programeve nga fusha e kulturës dhe traditës, gjë që do t'i vendoste studimet e doktoratës më afër zhvillimeve hulumtuese ndërkombëtare dhe mundësisë potenciale që rezultatet e fituara kërkimore të njiheshin brenda dhe jashtë Kosovës.** Në raste të caktuara, të organizohen programe të përbashkëta të doktoratës me institucione kredibile ndërkombëtare, duke angazhuar mentorë nga diaspora kosovare të cilët punojnë në institucione shkencore ndërkombëtare.

4. PËRFUNDIM

Rimëkëmbja e arsimit në Kosovë është temë për të cilën diskutohet që nga vitet e para të pasluftës, fillimisht me qëllim të rimëkëmbjes dhe kthimit të sistemit të arsimit në normalitet, ndërsa më vonë duke synuar reforma më të thella që avancojnë arsimin. Në këtë periudhë ka pasur përmirësim të dukshëm në kuptim të krijimit të kushteve për punë normale, por jo edhe përmirësim të cilësisë. Edhe pse janë zhvilluar politika e strategji, janë përcaktuar masa që duhet të ndërmerren për zhvillimin e sistemit të arsimit, shpesh me përkrahje ndërkombëtare për zbatimin e reformave në arsim, megjithatë, veprimet e institucioneve shtetërore nuk kanë

qenë koherente me qëllimet e proklamuar, duke iu përshtatur shpesh agjendave politike afatshkurta dhe interesave të ngushta politike e grupore. Hapja e universiteteve të reja publike pa asnjë analizë të mirëfilltë të nevojave, punësimet dhe emërimet politike, moszbatimi i legjislacionit dhe i politikave e strategjive të adoptuara, rritja e pakontrolluar e pagave për qëllime elektorale janë vetëm disa nga shkaqet e gjendjes aktuale në arsim.

Arsimi në Kosovë krijon përshtypje sikur nuk ka ndonjë qëllim dhe ekziston si inerci e vazhdimësisë së shkollimit që nga ai fillor e deri te shkollimi i lartë. Kjo amulli vlen jo vetëm për ata që shkollohen, duke i kaluar me automatizëm këto vite të jetës, por gjithashtu edhe për shtetin që e mban shkollimin për numra si në sektorin publik, ashtu edhe në sektorin privat. Formalisht institucionet mund të deklarojnë ulje të analfabetizmit klasik për shkak të rritjes së pjesëmarrjes në arsim, por ndërkaq nuk bëhet asgjë për praninë e analfabetizmit funksional, që e dëshmojnë edhe rezultatet e testit PISA. Për fat të keq edhe shkollimi privat në shumë raste lidhet me numra e jo me cilësi, e që në fakt shpeshherë nënkupton garancinë e marrjes së diplomës pasi ajo që paguhet edhe duhet të merret.

Përveç që kanë lejuar degradimin e cilësisë së arsimit dhe kanë dëmtuar gjenerata të tëra të rinjve, institucionet e Kosovës nuk ia kanë dalë ta ndërtojnë një sistem të bazuar në përgjegjësi dhe llogaridhënie, duke mos e zbatuar legjislacionin, politikat dhe standardet e proklamuar dhe duke e politizuar skajshëm sistemin e arsimit.

Nga një synim jetësor intelektual, universiteti është shndërruar në një mundësi punësimi për bartësit e funksioneve të larta publike, deputetë e ministra të cilët kualifikimet akademike i kanë fituar gjatë ushtrimit të funksionit, me përkrahje joparimore të një pjese të stafit akademik, të etur për favore e privilegje. Madje edhe studentët, të dëmtuarit kryesorë nga praktikat tanimë standarde korruptive, përmes organizatave dhe përfaqësuesve të vet janë vënë në funksion të klaneve të cilat pas kryerjes së studimeve i shpërblejnë me avancim në karrierë si dhe me poste nëpër institucione me rëndësi. Funksionimi i përfaqësuesve të studentëve si dorë e zgjatur e klaneve të caktuara i ka faktorizuar ata deri në atë masë sa të kenë rol vendimtar në secilën hallkë të jetës akademike, duke filluar që nga regjistrimi i studentëve e deri te angazhimi dhe avancimi i mësimdhënësve, përzgjedhja e menaxhmentit e të tjera. Ata e reprodukojnë modelin kulturor autoritar dhe servil, që i çon përpara ata studentë të cilët janë të dëgjueshëm, që e pranojnë në mënyrë të padiskutueshme hierarkinë e sjellë nga politika dhe që bashkëpunojnë me të. Këta bëhen trashëgimtarë të profesorëve jokompetentë që krijojnë vizion të pashpresë për brezat e ardhshëm.

Shoqëria kosovare është shoqëri pa vizion afatmesëm dhe afatgjatë zhvillimor të arsimit, nuk ka planifikim të projektuar të profileve arsimore, ka shkollim të paefektshëm, të padobishëm dhe pa të ardhme.

Mungesa e punës hulumtuese dhe e rezultateve konkrete në universitete dhe në institute e tregon mosefektshmërinë e mësimnxënies dhe studimit. Institucionet e arsimit të lartë me punën e vet shkencore e hulumtuese nuk i japin pothuajse fare shërbime as ekonomisë së vendit e as institucioneve shtetërore. Shkenca kosovare nuk është pjesë e asaj evropiane dhe nuk ka projekte të përbashkëta madje as kur trajtohen çështje që lidhen me Kosovën.

Për të tejkaluar procesin e ndërhyrjes politike dhe korrupsionit si dhe paradigmën e izolimit nga problemet shoqërore në arsimin kosovar, Akademia e Shkencës dhe e Arteve e Kosovës rekomandon:

- të instalohet sistem i mirëfilltë i përgjegjësisë dhe llogaridhënies në të gjitha nivelet, përfshirë institucionet arsimore, pushtetin lokal dhe institucionet qendrore;
- të ndërtohet sistemi efektiv dhe llogaridhënës i financimit i bazuar në parimet e menaxhimit të mirë të parasë publike;
- të vendosen standarde të larta kurikulare të arritjes që sigurojnë zhvillimin jo vetëm të shkathtësive specifike që kërkohen nga tregu i punës, por edhe të kompetencave personale, siç është kompetenca për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe kompetenca qytetare;
- të sigurohen tekste shkollore cilësore, duke garantuar proces të besueshëm të përzgjedhjes, të bazuar në konkurrencë të shëndoshë dhe kriteret e procedura transparente të vlerësimit;
- t'i kushtohet vëmendje e veçantë përmirësimit të vazhdueshëm të programeve universitare për përgatitjen e mësuesve përmes një procesi më rigoroz të akreditimit;
- të ristrukturohen institucionet rajonale të arsimit të lartë duke i reduktuar programet e shumëfishuara dhe duke e verifikuar stafin akademik për plotësimin e kërkesave profesionale dhe shkencore;
- të harmonizohet statusi juridik dhe emërtimi i këtyre institucioneve në përputhje me ligjin;
- të identifikohen dhe të filtrohen profesorët jokompetentë të cilët janë pjesë e arsimit të lartë dhe të cilët e riprodhojnë veten duke e sjellë edhe stafin e ri sipas standardit të vet;
- të kërkohet nga profesorët të cilët angazhohen me poste politike dhe ekzekutive që ta pezullojnë marrëdhënien e punës me IAL;
- të depolitizohet roli i studentëve dhe përfaqësuesit e tyre të zgjidhen duke respektuar kriteret maksimale profesionale dhe etike;

- të ndërpritet ndërhyrja e politikës në pavarësinë e Agjencisë së Kosovës për Akreditim në mënyrë që ky institucion të jetë i besueshëm;
- të organizohen programet doktorale edhe në gjuhën angleze për të qenë më afër zhvillimeve hulumtuese ndërkombëtare dhe
- institucionet hulumtuese të shtjellojnë projekte si përgjigje ndaj problemeve shoqërore në funksion të zhvillimit shoqëror, kulturor, ekonomik e politik të vendit.

PLATFORMË PËR RIMËKËMBJEN E ARSIMIT NË KOSOVË

2021

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Lektor:

Shefqet Riza

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia: 7.5 tabakë shtypi

Tirazhi: 200 copë

Formati: 23x28 cm

Shtypi:

Focus Print

Shkup

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

37(496.51)

Platformë për rimëkëmbjen e arsimit në Kosovë / Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. - Prishtinë : Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, 2021. – 58 f. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-26-039-8



ISBN 978-9951-26-039-8



9 789951 260398